

The background image shows a person in a grey suit jacket looking at a tablet. The tablet screen displays a bar chart with several bars of varying heights. To the left, a laptop screen also shows a similar bar chart. The scene is set in an office environment with papers and a keyboard visible on a desk. A large, stylized circular graphic is overlaid on the center of the image, consisting of several concentric, broken rings in shades of blue and white, resembling a target or a data visualization element.

**SFIDA E TË DHËNAVE
STATISTIKORE DHE
TREGUESVE PËR ARSIMIN
E LARTË NË KOSOVË**

**SFIDA E TË DHËNAVE
STATISTIKORE DHE
TREGUESVE PËR ARSIMIN
E LARTË NË KOSOVË**

PRISHTINË, MAJ 2023

Sfida e të dhënave statistikore dhe treguesve për arsimin e lartë në Kosovë

Autorë:

Dukagjin Pupovci
Besjan Haziri

Redaktore gjuhësore:

Afrore Lila

Publikuar nga:

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Kompleksi i Shkollës “Mileniumi i Tretë”
rr. “Qëndresa” nr. 48, Matičan,
10000 Prishtinë, Kosovë
www.kec-ks.org
office@kec-ks.org

Design: Envinion



Shënim: Qendra për Arsim e Kosovës është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet – KITU, i mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. Ky hulumtim është pjesë e programit të KITU-s. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të autorëve dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS.

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	7
Përmbledhje ekzekutive.....	8
1. Hyrje.....	10
2. Qëllimet e hulumtimit dhe metodologjia	12
3. Të dhënat statistikore dhe treguesit në rrafshin global.....	13
3.1. Klasifikimi i të dhënave.....	14
3.2. Llojet e të dhënave	15
3.3. Treguesit e arsimit të lartë.....	19
4. Të dhënat statistikore në Kosovë dhe krahasimi me vendet fqinje	22
4.1. Të dhënat statistikore.....	22
4.2. Të dhënat statistikore në burim	23
4.2.1. Agjencia e Statistikave e Kosovës.....	23
4.2.2. MASHTI	24
4.2.3. Universiteti i Prishtinës.....	25
4.3. Treguesit	25
4.4. Përvojat nga vendet fqinje.....	26
5. Sfidat kryesore të statistikave të arsimit të lartë në Kosovë.....	28
5.1. Politikat dhe legjislacioni.....	28
5.2. Cilësia dhe harmonizimi me standarde ndërkombëtare	29
5.3. Shfrytëzimi i të dhënave për vendimmarrje.....	30

6. Hapat në vazhdim - mundësitë për adresimin e problemit	31
6.1. Përcaktimi i kërkesave për të dhëna	31
6.1.1. Të dhënat për studentët	31
6.1.2. Të dhënat për personelin akademik	33
6.1.3. Të dhënat për shpenzimet	35
6.2. Zhvillimi i sistemeve për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave.....	36
6.3. Paketa e treguesve kombëtarë të arsimit të lartë	37
6.4. Kapacitetet dhe ndarja e përgjegjësive për statistikat e arsimit të lartë.....	38
7. Përfundimet dhe rekomandimet	40
Literatura	42
Shtojcë: Lista e të intervistuarve.....	46

Lista e shkurtesave

AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
ASK	Agjencia e Statistikave e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
EUROSTAT	Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
INSTAT	Instituti i Statistikave i Shqipërisë
ISCED	Standardi Ndërkombëtar për Klasifikimin e të Dhënave të Arsimit
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
MAKSTAT	Enti Shtetëror i Statistikës i Maqedonisë së Veriut
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MONSTAT	Drejtoria për Statistikë e Malit të Zi
UOE	Manuali i përbashkët i UNESCO, OECD dhe EUROSTAT
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
PSZ	Programi i Statistikave Zyrtare
RZS	Enti Republikan i Statistikës i Serbisë
SEMS	Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve
SIMFK	Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave Publike
SMIA	Sistemi për Menaxhimin e Informacionit në Arsim
SMIAL	Sistemi për Menaxhim të Informatave në Arsimin e Lartë
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë e Kulturë
UIS	Instituti i Statistikës i UNESCO
WB	Banka Botërore

Përmbledhje ekzekutive

Në këtë raport paraqitet një analizë e sistemit aktual të mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave statistikore për arsimin e lartë në Kosovë, bashkë me praktikën ndërkombëtare dhe rajonale lidhur me këtë temë. Hulumtimi është i karakterit cilësor dhe shfrytëzon si burim informacioni literaturën vendore dhe ndërkombëtare, si dhe intervistat me aktorët kyçë në procesin e prodhimit dhe shfrytëzimit të statistikave të arsimit të lartë në Kosovë. Në fillim, prezantohen informacione për të dhënat statistikore dhe treguesit në rrafshin global, siç përcaktohen nga organizatat më prestigjioze ndërkombëtare që prodhojnë statistika të arsimit të lartë. Pastaj, shpjegohet sistemi i mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të statistikave në Kosovë dhe në vendet fqinje.

Raporti zbulon se problemet me statistikat dhe me treguesit e arsimit të lartë në Kosovë janë të natyrës shumëdimensionale. Sistemi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nuk është i strukturuar në mënyrë që të sigurojë efektivitet në mbledhjen, ruajtjen, përpunimin dhe shkëmbimin e të dhënave në mes të institucioneve të ndryshme. Gjithashtu, mungojnë kapacitetet teknike dhe organizative që të sigurohet një proces i besueshëm i mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave statistikore dhe të treguesve. Shfrytëzimi i të dhënave statistikore dhe i treguesve në procesin e vendimmarrjes është shumë i kufizuar për shkak të mungesës së të dhënave, por edhe për shkak të kulturës së vendimmarrjes pa u mbështetur në të dhëna, e cila rezulton me mungesë të kërkesës për të dhëna.

Në këtë kontekst, raporti rekomandon se, që të përmirësohet sistemi i mbledhjes dhe raportimit të të dhënave duhet të kuptohet se cilat të dhëna janë të nevojshme dhe si duhet të strukturohen. Në këtë drejtim, raporti jep disa sugjerime konkrete që bazohen në praktikën më të mira ndërkombëtare. Po ashtu, duhet të përcaktohen treguesit që duhet raportuar dhe të sigurohet që të dhënat e mbledhura janë të besueshme dhe të rregullta. Ndërkaq, që të përmirësohet shfrytëzimi i të dhënave në procesin e vendimmarrjes, duhet të zhvillohet kultura e mbështetjes së vendimmarrjes në të dhëna dhe të bëhet përdorimi i tyre si burim i njohurisë dhe i informatave për të nxjerrë vendime të informuara. Raporti, gjithashtu argumenton, se që të sigurohet përmirësimi i cilësisë së statistikave dhe treguesve, duhet të përmirësohet kapaciteti teknik dhe organizativ në nivelin e institucioneve përgjegjëse, duke filluar nga zhvillimi i sistemeve komplekse për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave deri te ndarja e qartë e përgjegjësive në mes të institucioneve dhe te sigurimi i burimeve njerëzore të domosdoshme.

Rekomandimet e përgjithshme të raportit janë përmbledhur në vijim:

- 1** MASHTI, AKA dhe agjencitë tjera qeveritare, në koordinim me ASK-në t'i përcaktojnë qartë kërkesat e tyre për të dhëna statistikore që do të jenë në funksion të informimit të publikut dhe vendimmarrjes së informuar. Udhëzimet metodologjike të UNESCO, OECD dhe EUROSTAT mund të jenë një pikënisje e mirë për këtë rrugëtim.
- 2** ASK ta marrë rolin udhëheqës në koordinimin e procesit të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave të arsimit të lartë, ndërsa MASHTI, AKA dhe agjencitë tjera qeveritare të sigurojnë qasje në të dhënat e tyre këtij sektori.
- 3** Sistemi SMIAL për mbledhjen e të dhënave nga institucionet e arsimit të lartë të mbindërtohet ose të zhvillohet i ri në mënyrë që të ofrojë të dhëna statistikore të nevojshme dhe të krahasueshme me standardet ndërkombëtare. Një proces i tillë mund të kërkojë investime domethënëse në teknologji të informacionit.
- 4** Deri në zhvillimin e një sistemi SMIAL që bën të mundur mbledhje të automatizuar të të dhënave nga institucionet e arsimit të lartë dhe përpunim efektiv të tyre, ASK dhe MASHTI të bëjnë zgjidhje të përkohshme, duke i mbledhur e përpunuar të dhënat përmes sistemeve që aktualisht janë në dispozicion.
- 5** MASHTI të fillojë punën në hartimin e paketës së treguesve për arsimin e lartë, duke përzgjedhur tregues të cilët mund të përlllogariten me të dhënat që janë në dispozicion dhe i shërbejnë përcjelljes së progresit në fushën e arsimit të lartë.
- 6** MASHTI e ASK të analizojnë nevojat për ndryshime organizative e burime njerëzore që bëjnë të mundur prodhimin e statistikave cilësore në fushën e arsimit të lartë, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e secilit subjekt.

1. Hyrje

Të dhënat janë një mjet kyç për politik-bërësit për marrjen e vendimeve të informuara dhe për krijimin e politikave efektive që mbështesin rritjen dhe zhvillimin e sistemit të arsimit të lartë. Përmes të dhënave, politik-bërësit e kuptojnë gjendjen aktuale të sistemit të arsimit të lartë, identifikojnë fushat që kanë nevojë për përmirësim dhe vlerësojnë ndikimin e politikave aktuale. Duke mbledhur dhe analizuar të dhëna për regjistrimin, normat e diplomimit, demografinë e studentëve dhe ndihmën financiare, qeveria mund të identifikojë pabarazitë në qasje dhe sukses midis grupeve të ndryshme shoqërore. Pastaj, ky informacion mund të përdoret për të zhvilluar politika dhe programe që synojnë adresimin e këtyre pabarazive dhe për përmirësimin e qasjes e të suksesit për grupet e nënpërfaqësuar. Të dhënat mund të përdoren gjithashtu që të vlerësohet efektiviteti i politikave dhe programeve ekzistuese. Për shembull, duke analizuar numrin e studentëve që marrin pjesë në një program specifik dhe duke krahasuar rezultatet e tyre me ato të një grupi kontrolli, politik-bërësit mund të përcaktojnë nëse programi po i arrin qëllimet e synuara dhe të bëhen përmirësime sipas nevojës. Të dhënat mbi kërkesat e tregut të punës mund të përdoren që të informohen vendimet në lidhje me zhvillimin dhe financimin e programeve studimore. Në përgjithësi, të dhënat janë mjet i pazëvendësueshëm që të nxitet përmirësimi i cilësisë së arsimit të lartë.

Në kontekstin e globalizimit të arsimit të lartë në botë është me rëndësi që të dhënat statistikore dhe treguesit (indikatorët) të jenë të krahasueshëm ndërkombëtarisht. Organizatat ndërkombëtare si Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë e Kulturë (UNESCO), Organizata për Bashkëpunim

Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), Zyra Statistike e Bashkimit Evropian (EUROSTAT), Banka Botërore (WB) e ndonjë tjetër tanimë kanë përcaktuar tregues për të cilët raportohet me rregull dhe mbi bazën e të cilëve mund të bëhen krahasime të sistemeve të arsimit të lartë. Sistemet e treguesve për arsimin e lartë mund të kenë qëllime të ndryshme, gjë që ndikon në strukturën, shtrirjen dhe natyrën e informacionit që ato përmbajnë. Sipas Martin & Sauvageot (2011) mund të dallohen tri forma të shfrytëzimit të sistemeve të treguesve: 1) informimi i publikut ose qeverisë për gjendjen e sistemit të arsimit të lartë; 2) monitorimi i progresit të një politike, strategjie ose plani që është duke u zbatuar; dhe 3) menaxhimi i sistemit të arsimit të lartë.

Megjithatë, një parakusht i rëndësishëm për vënien në përdorim të një sistemi të treguesve është ekzistimi i një sistemi funksional për menaxhimin e të dhënave për arsimin e lartë. Kosova ka një sistem të fragmentuar të të dhënave statistikore për arsimin e lartë, të cilat rëndom raportohen në vjetarët statistikorë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Në mungesë të një sistemi gjithëpërfshirës për menaxhimin e të dhënave të arsimit të lartë, të dhënat statistikore përditësohen në baza vjetore, ndërkohë që nuk bëhet ndonjë llogaritje ose raportim i treguesve relevantë statistikorë për arsimin e lartë.

Mungesa e të dhënave statistikore dhe e treguesve të arsimit të lartë në Kosovë është identifikuar si problem edhe në Strategjinë e Arsimit 2022-2026 (MASHTI, 2022a) dhe në planin e saj të veprimit (MASHTI, 2022b), ku parashihet zhvillimi i treguesve kombëtarë

për arsimin e lartë si dhe nxjerrja e një akti nënligjor lidhur me këtë. Po në këto dokumente parashihet edhe zhvillimi i një sistemi të ri për menaxhimin e informacionit në arsimin e lartë, i cili do të duhej të shërbente për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave

statistikore në këtë fushë. Ky hulumtim i paraprin këtij procesi dhe, po ashtu, i kontribuon nxitjes së debatit për menaxhimin e mirë të sistemit të arsimit të lartë, përfshirë politik-bërjen e bazuar në të dhëna, transparencën dhe llogaridhënien.

Përmbajtje e shkurtër e kapitujve vijues:

Kapitulli 2

Në kapitullin 2 prezantohen qëllimet e hulumtimit dhe metodologjia e përdorur.

Kapitulli 3

Në kapitullin 3 jepen informacione për të dhënat statistikore dhe treguesit në rrafshin global. Si pikënisje shërben Standardi Ndërkombëtar për Klasifikimin e të Dhënave të Arsimit (ISCED), për të sqaruar pastaj të dhënat dhe treguesit që përdoren nga organizatat më prestigjioze ndërkombëtare: Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë e Kulturë (UNESCO), Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian (EUROSTAT), dhe Banka Botërore (WB).

Kapitulli 4

Në kapitullin 4 flitet për të dhënat statistikore për arsimin e lartë në Kosovë dhe institucionet kryesore që i mbledhin, i përpunojnë dhe i publikojnë ato. Po ashtu, prezantohen treguesit ekzistues për arsimin e lartë, si dhe gjendja e statistikave të arsimit të lartë në vendet fqinje: Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi dhe Serbi.

Kapitulli 5

Kapitulli 5 i kushtohet analizës së sfidave për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave statistikore nga këndvështrimi i politikave dhe i legjislacionit, cilësia e harmonizimit me standarde ndërkombëtare, si dhe shfrytëzimi i tyre për vendimmarrje.

Kapitulli 6

Në kapitullin 6 shqyrtohen disa mundësi për adresimin e problemeve të identifikuara, përfshirë përcaktimin e kërkesave për të dhëna, sistemet për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, përzgjedhjen e treguesve kombëtarë të arsimit të lartë dhe ndërtimin e kapaciteteve për prodhimin e statistikave cilësore.

Kapitulli 7

Në kapitullin 7 përmbledhen përfundimet dhe rekomandimet e hulumtimit.

2. Qëllimet e hulumtimit dhe metodologjia

Qëllimet e këtij hulumtimi janë:

- 1 analizimi i sistemit aktual të mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave statistikore, si dhe të treguesve për arsimin e lartë në Kosovë;
- 2 prezantimi i praktikave ndërkombëtare dhe rajonale përkitazi me këtë tematikë;
- 3 nxjerrja e rekomandimeve për të dhënat dhe për treguesit që duhet raportuar në të ardhmen.

Hulumtimi është i karakterit cilësor dhe është realizuar në katër faza:

- 1 Analiza e burimeve ekzistuese, të cilat përfshijnë materiale ku shtjellohet çështja e të dhënave statistikore dhe e treguesve për arsimin e lartë të hartuara nga organizma ndërkombëtarë si UNESCO, OECD, EUROSTAT, WB, etj. Përveç tyre, janë analizuar pakot e të dhënave statistikore dhe treguesve të arsimit të lartë nga UNESCO, OECD, EUROSTAT e Banka Botërore, si dhe raportet statistikore dhe treguesit nga institutet/agjencitë e statistikave të vendeve fqinje të Kosovës si: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi e Serbia.
- 2 Intervista individuale me njohës të problematikës. Në fazën e parë janë identifikuar problemet dhe çështjet e hapura rreth të dhënave statistikore dhe treguesve për arsimin e lartë në Kosovë. Mbi bazën e kësaj analize janë përgatitur protokollat për intervista gjysmë të struk-

turuara me zyrtarë të MASHTI, ASK, ekspertë të arsimit, etj. Të gjitha intervistat janë dokumentuar në formë elektronike. Lista e të intervistuarve është dhënë në shtojcën e këtij raporti.

- 3 Hartimi dhe verifikimi i draft-raportit. Nga informatat e mbledhura në dy fazat e para të hulumtimit është hartuar draft-raporti me gjetje dhe rekomandime përkatëse. Me qëllim të verifikimit të gjetjeve dhe rekomandimeve është organizuar një punëtori ku janë ftuar personat që kanë ofruar informacion për hulumtimin, si dhe persona të tjerë që kanë kontribuar në përmirësimin e draftit.
- 4 Raporti final është hartuar në bazë të rezultateve të punëtorisë dhe të komenteve që janë pranuar.

3. Të dhënat statistikore dhe treguesit në rrafshin global

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë e Kulturë (UNESCO), Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian (EUROSTAT) dhe Banka Botërore (WB) janë katër organizata që përcaktojnë standardin ndërkombëtar për të dhënat statistikore në fushën e arsimit.

UNESCO, OECD dhe EUROSTAT kanë zhvilluar manualin e përbashkët për mbledhjen e të dhënave për të gjitha nivelet e arsimit formal, i cili përditësohet në intervale të rregullta kohore (UOE, 2022). Ky manual përcakton konceptet, përkufizimet dhe klasifikimet që përdoren për mbledhjen e të dhënave nga UNESCO, OECD e EUROSTAT, dhe ka për qëllim sigurimin e të dhënave që janë të krahasueshme në nivelin ndërkombëtar.

Secila nga organizatat e lartpërmendura ka udhëzuesit e vet për mbledhjen, përpunimin dhe prezantimin e të dhënave, si dhe bazat e të dhënave që janë publike. Si rregull, klasifikimi bëhet duke u bazuar në Standardin Ndërkombëtar për Klasifikimin e të Dhënave të Arsimit ISCED 2011 (UNESCO, 2012), si dhe në Standardin ISCED-F-2013 që përcakton fushat e arsimit dhe të trajnimit (UNESCO, 2015).

UNESCO mbledh të dhëna për arsimin e lartë nga 193 vende anëtare, të cilat prezantohen në bazën e të dhënave të Institutit të Statistikës të UNESCO (UIS) (UIS, 2023). Baza e të dhënave është ndërvepruese

dhe përmban filtra cilësorë që mundësojnë përzgjedhjen e të dhënave në bazë të kriterëve të ndryshme.

OECD mbledh të dhëna nga 38 vende anëtare duke shfrytëzuar një metodologji të sqaruar mirë në manual të veçantë (OECD, 2017). Përveç bazës së të dhënave (OECD, 2023), OECD publikon me rregull raportin vjetor me të dhëna statistikore të quajtur “Education at a glance” (OECD, 2022).

EUROSTAT mbledh të dhëna nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE), nga shtetet kandidate dhe nga shtetet e Zonës Ekonomike Evropiane. Këto të dhëna janë në dispozicion në bazën e të dhënave (EUROSTAT, 2023b), ndërsa kohë pas kohe bëhen publikime tematike me të dhëna të caktuara.

Banka Botërore i prezanton të dhënat nga 189 shtetet anëtare në bazën e saj të të dhënave (World Bank, 2023), e cila është mjaft e avancuar sa i përket cilësisë së prezantimit të të dhënave dhe mundësive për krahasim. Përveç të dhënave në fushën e arsimit, aty mund të gjenden edhe të dhëna për sektorë të tjerë, si dhe për projektet e Bankës Botërore anekënd botës.

Në vijim është përqendrimi vetëm te të dhënat për arsimin e lartë.

3.1. Klasifikimi i të dhënave

Për klasifikimin e të dhënave në fushën e arsimit të lartë përdoret sistemi ISCED 2011 (UNESCO, 2012) dhe ISCED-F-2013 (UNESCO, 2015). Sistemi ISCED 2011 i ndan 4 kode për arsimin e lartë:

ISCED 5 – Arsimi terciar me cikël të shkurtër;
ISCED 6 – Bachelor ose nivel i barasvlershëm;
ISCED 7 – Master ose nivel i barasvlershëm;
ISCED 8 – Doktoratë ose nivel i barasvlershëm.

Në rastin e Kosovës, këto kode korrespondojnë me nivelet e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (AKK, 2020), gjë që e lehtëson mbledhjen dhe analizën e të dhënave. Më tutje, sistemi ISCED ndan nënkode dyshifrore për përshkrimin e vetive specifike të programeve, si për shembull për nivelin Bachelor janë në përdorim kodet dyshifrore:

ISCED 64 – Bachelor ose nivel i barasvlershëm, programe akademike;
ISCED 65 – Bachelor ose nivel i barasvlershëm, programe profesionale;
ISCED 66 – Bachelor ose nivel i barasvlershëm, orientim i papërcaktuar.

Për secilin klasifikim dyshifror përdoren kode treshifrore për përshkrimin edhe të më-tutjeshëm të programit përkatës. Për shembull për programet “ISCED 64 – Bachelor ose nivel i barasvlershëm, programe akademike”, janë në përdorim katër kode treshifrore:

ISCED 641 – I pamjaftueshëm për përfundimin e nivelit;
ISCED 645 – Diploma e parë (3-4 vjet);
ISCED 646 – Diploma e parë e zgjatur (më shumë se 4 vjet);
ISCED 647 – Diploma e dytë ose më shumë, pas përfundimit të suksesshëm të një programi Bachelor ose të barasvlershëm.

Sisteme të ngjashme të kodeve dy dhe treshifrore përdoren edhe për nivelet 5, 7 dhe 8 të ISCED.

Përveç klasifikimit sipas niveleve të studimit, me rëndësi është edhe klasifikimi sipas fushave të studimit, që përcaktohet me sistemin ISCED-F-2013, i cili ka në përdorim 11 fusha themelore të studimit që identifikohen me kode 2-shifrore:

- 00. Programet dhe kualifikimet e përgjithshme
- 01. Arsimi
- 02. Artet dhe shkencat humane
- 03. Shkencat shoqërore, gazetaria dhe informimi
- 04. Biznesi, administrata dhe drejtësia
- 05. Shkencat natyrore, matematika e statistika
- 06. Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit
- 07. Inxhinieria, prodhimtaria dhe ndërtimtaria
- 08. Bujqësia, pylltaria, peshkataria dhe veterina
- 09. Shëndeti dhe mirëqenia
- 10. Shërbimet

Për secilën nga këto fusha, me kode treshifrore përcaktohet një numër i fushave të ngushta (*narrow fields*) përkatëse, për shembull, për fushën “10. Shërbimet” janë shtatë fusha të ngushta:

- 100. Shërbimet jo të definuara
- 101. Shërbimet personale
- 102. Shërbimet e higjienës dhe shëndetit në punë
- 103. Shërbimet e sigurisë
- 104. Shërbimet e transportit
- 108. Programet ndërdisiplinore dhe kualifikimet që përfshijnë shërbime
- 109. Shërbimet që nuk janë klasifikuar diku tjetër

Më tutje, për secilën fushë të ngushtë, me kode 4-shifrore përcaktohet një numër i fushave të detajuara (*detailed fields*), për shembull për fushën e ngushtë “103. Shërbimet e sigurisë” janë katër fusha të detajuara:

- 1030. Shërbimet e sigurisë të padefinuara
- 1031. Ushtria dhe mbrojtja
- 1032. Mbrojtja e personave dhe e pasurisë
- 1039. Shërbimet e sigurisë që nuk janë klasifikuar diku tjetër

3.2. Llojet e të dhënave

Manuali i përbashkët i UNESCO, OECD dhe EUROSTAT (UOE, 2022) përcakton disa kategori të të dhënave që kërkohen nga të tria organizatat, por secila prej tyre mban të drejtën të kërkojë edhe të dhëna të tjera në pajtim me nevojat e veta. Të dhënat për arsimin e lartë mund të ndahen në pesë kategori: studentët e regjistruar, studentët e regjistruar për herë të parë, të diplomuarit, personeli akademik dhe shpenzimet. Të dhënat sipas këtyre kategorive janë prezantuar në tabelën 1. Nga tabela shihet se UNESCO, OECD dhe EUROSTAT i kanë disa kërkesa të përbashkëta për të dhëna, por që kanë edhe kërkesa specifike.

Studentët e regjistruar (ENRL) paraqesin totalin e numrit të studentëve që vijojnë programet e caktuara gjatë periudhës referente, e që zakonisht është fillimi i vitit akademik. Në parim, të gjithë studentët duhet të numërohen vetëm një herë, përfshirë ata që studiojnë në më shumë programe njëkohësisht.

Studentët e regjistruar për herë të parë (ENTR) janë studentët që fillojnë studimet në një program të studimit në periudhën referente, pavarësisht nëse inkuadrohen në vitin e parë të studimeve apo në ndonjërin nga vitet vijuese varësisht nga transferimi i kreditit të akumuluar.

Të diplomuarit (GRAD) janë personat, të cilët i kanë përfunduar me sukses studimet gjatë vitit akademik referent. Në mesin e tyre dallohen ata që kanë diplomuar për herë të parë në nivelin përkatës të studimeve dhe ata që kanë diplomuar për herë të dytë ose më shumë brenda nivelit.

Personeli akademik (PERS) përbëhet nga të gjithë të punësuarit e institucioneve të arsimit të lartë që detyrë primare e kanë mësimdhënien ose kërkimin, përfshirë udhëheqësit akademikë (rektori, dekani, e të ngjashme). Nëse personeli akademik kontribuon në më shumë se një nivel të arsimit, ngarkesa me punë zërthehet sipas niveleve, ndërsa nëse nuk është e mundur të kalkulohet, ndahet në mënyrë të barabartë sipas niveleve.

Shpenzimet (FIN) janë kategori e cila përfshin të gjitha shpenzimet nga burimet publike, private dhe ndërkombëtare që bëhen për arsimin e lartë. Në këtë kategori përfshihen edhe shpenzimet e hulumtimeve që realizohen brenda institucioneve të arsimit të lartë, si dhe subvencionet publike për studentë. Shpenzimet private përfshijnë të gjitha shpenzimet që bëhen për pagesën e tarifave studentore, të materialeve mësimore, si dhe shpenzimet e jetesës, por vetëm nëse këto subvencionohen nga burime publike ose private. Të dhënat për shpenzime private zakonisht mblidhen përmes anketave të ekonomive shtëpiake.

Të dhënat nga tabela e mëposhtme mblidhen përmes formularëve të veçantë nga UNESCO, OECD e EUROSTAT, dhe publikohen në bazën përkatëse të të dhënave. Vërehet se jo të gjitha shtetet i prezantojnë të dhënat në mënyrë të rregullt dhe të plotë e që mund të jetë rezultat i organizimeve të brendshme dhe i kapaciteteve të kufizuara.

TABELA 1. Të dhënat *statistikore* për arsimin e lartë që kërkohen nga UNESCO, OECD, EUROSTAT

Të dhënat	Përshkrimi	Kërkohen nga		
		UNESCO	OECD	EUROSTAT
Studentët e regjistruar (ENRL)				
ENRL1A-INST: Numri i studentëve sipas tipit të institucionit dhe të gjinisë (Shifra e parë dhe e dytë e ISCED)	<i>Tipi i institucionit:</i> 1. Publik 2. Privat 2.1. i varur nga Qeveria 2.2. i pavarur <i>Klasifikimi i programeve:</i> ISCED 5: Të gjitha programet; Të përgjithshme; Profesionale; Shkolla të kombinuara dhe sistem dualist ISCED 6-7: Të gjitha programet; Akademike; Profesionale ISCED 8: Të gjitha programet	Vetëm shifra e parë e ISCED	Vetëm shifra e parë e ISCED	Shifra e parë dhe e dytë e ISCED
ENRL1B-INST: Numri i studentëve sipas tipit të institucionit dhe të gjinisë (Kodi 3-shifror i ISCED)		Vetëm për programet ISCED 6 me orientim të papërcaktuar	Jo	Po
ENRL2-AGE&P: Numri i studentëve me kohë të plotë dhe të pjesshme sipas moshës dhe sipas gjinisë	<i>Orientimi programor:</i> ISCED 5: Të gjitha programet; Të përgjithshme; Profesionale ISCED 6-7: Të gjitha programet; Akademike; Profesionale ISCED 8: Të gjitha programet	Vetëm shifra e parë e ISCED	ISCED 5: Shifra e parë dhe e dytë e ISCED ISCED 6-8: Vetëm shifra e parë e ISCED	ISCED 5: Shifra e parë dhe e dytë e ISCED ISCED 6-8: Vetëm shifra e parë e ISCED, shifra e dytë opsionale
ENRL3-AGE&P: Numri i studentëve me kohë të pjesshme sipas moshës dhe gjinisë		Jo	Po	Jo
ENRL4-FIELD: Numri i studentëve sipas fushës së studimit dhe gjinisë (kodet dyshifrore)		Nivelet ISCED 6-8 – institucionet me orientim të papërcaktuar	Nivelet ISCED 5-8 sipas tipit të institucionit	Niveli ISCED 5 sipas tipit të institucionit, Nivelet 6-8 – institucionet me orientim të papërcaktuar
ENRL4-FIELD: Numri i studentëve sipas fushës së studimit dhe gjinisë (kodet treshifrore)		Jo		

Të dhënat	Përshkrimi	Kërkohen nga		
		UNESCO	OECD	EUROSTAT
ENRL5-MOB&FIELD: Numri i studentëve mobilë sipas fushës së studimit (kodi 4-shifror) dhe sipas gjinisë	Student mobil konsiderohet student i cili vjen nga një shtet tjetër dhe i ka regjistruar studimet në shtetin pranues, me qëllim që t'i përfundojë aty.	Jo	Po	Po
ENRL6-MOB&COUNTRY: Numri i studentëve mobilë sipas vendit të origjinës dhe të gjinisë	Në këtë kategori nuk bëjnë pjesë studentët që ndjekin programet e mësimi në distancë dhe as studentët nga shtetet tjera që kalojnë periudha të shkurtra studimi në shtetin pranues.	Po	Po Për ISCED 5 të klasifikuar sipas tipave të institucioneve	Po
Studentët e regjistruar për herë të parë (ENTR)				
ENTR1: Studentët e regjistruar për herë të parë sipas moshës dhe sipas gjinisë		Po	Po	Po ISCED 6-8
ENTR2: Studentët mobilë të regjistruar për herë të parë sipas moshës dhe sipas gjinisë		Jo	Po	Jo
ENTR3: Studentët e regjistruar për herë të parë sipas fushës së studimit e të gjinisë	Kodi ISCED-F i fushës së studimit është treshifror	Jo	Po	Po ISCED 6-8
Të diplomuarit (GRAD)				
GRAD1-INST: Numri i të diplomuarve sipas tipit të institucionit dhe sipas gjinisë		Jo	Po	Jo
GRAD2-AGE: Numri i të diplomuarve sipas moshës dhe sipas gjinisë		Jo	Po ISCED 5 dhe ISCED 8	Po ISCED 5-8
GRAD3-FIRST&AGE: Numri i të diplomuarve për herë të parë sipas moshës e të gjinisë	I diplomuar për herë të parë konsiderohet personi i cili nuk ka diplomuar më herët në ndonjë program nga niveli i njëjtë i studimeve	Jo	Po	Opsionale

Të dhënat	Përshkrimi	Kërkohen nga		
		UNESCO	OECD	EUROSTAT
GRAD4-MOB&AGE: Numri i të diplomuarve mobilë dhe i atyre për herë të parë sipas moshës dhe gjinisë	I diplomuar mobil konsiderohet studenti i cili ka ardhur nga një shtet tjetër dhe i ka regjistruar studimet në shtetin pranues me qëllim që t'i përfundojë aty.	Jo	Po	Jo
GRAD5-FIELD: Numri i të diplomuarve sipas fushës së studimit dhe gjinisë	Kodi ISCED-F i fushës së studimit është treshifror OECD dhe EUROSTAT kanë disa kërkesa specifike në raport me klasifikimin e programeve	Po	Po	Po
GRAD6-FIELD: Numri i të diplomuarve mobilë sipas fushës së studimit dhe të gjinisë		Jo	Po	Jo
GRAD7-FIELD: Numri i të diplomuarve mobilë sipas vendit të origjinës dhe të gjinisë		Jo	Po	Po
Personeli (PERS)				
PERS1-STUD: Numri i studentëve i përshtatur për personelin akademik sipas nivelit arsimor, orientimit programor, tipit të institucionit dhe kohës së studimit	<i>Koha e studimit:</i> 1) Me kohë të plotë 2) Me kohë të pjesshme	Jo	Po Për ISCED 5 dhe kumulative për ISCED 6-8	Po Kumulative për ISCED 5-8 Opsionale sipas orientimit programor
PERS2-INST: Personeli akademik sipas tipit të institucionit, ngarkesës me punë dhe gjinisë	<i>Ngarkesa me punë:</i> 1) Me orar të plotë 2) Me orar të pjesshëm nëse ka më pak se 90% nga orari i plotë gjatë vitit	Po Për ISCED 5 dhe kumulative për ISCED 5-8	Po Për ISCED 5 dhe kumulative për ISCED 6-8	Po Kumulative për ISCED 5-8 Opsionale sipas orientimit programor
PERS3-AGE: Personeli akademik sipas nivelit arsimor, orientimit programor, gjinisë dhe moshës		Jo	Po Për ISCED 5 dhe kumulative për ISCED 6-8	Po Kumulative për ISCED 5-8 Opsionale sipas orientimit programor

Të dhënat	Përshkrimi	Kërkohen nga		
		UNESCO	OECD	EUROSTAT
Shpenzimet (FIN)				
FIN-STUDENTS: Numri i studentëve i përshtatur për financimin e arsimit (për vitin referent dhe të dhënat financiare) sipas tipit të institucionit dhe kohës së studimit		Jo	Po Për ISCED 5, kumulative për ISCED 6-8 dhe ISCED 5-8	Po Për ISCED 5, kumulative për ISCED 6-8, Opsionale për ISCED 5-8 dhe sipas orientimit programor
FIN1-SOURCE: Shpenzimet për arsim sipas burimit, llojit të transaksionit dhe nivelit arsimor	<p><i>Burimi i financimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria (niveli qendror, rajonal ose lokal); - Agjencitë ndërkombëtare dhe burimet tjera të huaja; - Ekonomitë shtëpiake dhe entitetet tjera private e jopublike, përfshirë edhe ato jopërfituese. <p><i>Lloji i transaksionit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Shpenzime direkt – pagesa institucioneve arsimore të zërthyera sipas tipave të institucioneve; - Transferime brenda niveleve të qeverisë; - Transferime studentëve ose ekonomive shtëpiake, si dhe entiteteve tjera private. 	Po Për ISCED 5, kumulative për ISCED 6-8 dhe ISCED 5-8	Po Për ISCED 5, kumulative për ISCED 6-8 dhe ISCED 5-8	Po Për ISCED 5, kumulative për ISCED 6-8, Opsionale për ISCED 5-8 dhe sipas orientimit programor
FIN2-NATURE: Shpenzimet për arsim sipas tipit të institucionit, kategorisë shpenzuese dhe nivelit arsimor	<p>Kategoritë shpenzuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shpenzimet rrjedhëse; - Shpenzimet kapitale. 	Po Për ISCED 5, kumulative për ISCED 6-8 dhe ISCED 5-8	Po Për ISCED 5, kumulative për ISCED 6-8 dhe ISCED 5-8	Po Për ISCED 5, kumulative për ISCED 6-8, Opsionale për ISCED 5-8 dhe sipas orientimit programor

Burimi: (UOE, 2022), (EUROSTAT, 2023a).

3.3. Treguesit e arsimit të lartë

Ndonëse nuk ekziston një konsensus i përgjithshëm për treguesit e arsimit të lartë, organizatat si UNESCO, OECD, EUROSTAT dhe Banka Botërore kanë përcaktuar disa tregues

të cilët raportohen me rregull në publikimet e tyre. Disa nga këta tregues janë dhënë në tabelën 2. Për kalkulimin e treguesve shfrytëzohen të dhënat statistikore nga tabela 1, ndërse, në raste të caktuara, mund të ketë nevojë për të dhëna plotësuese.

TABELA 2. Disa nga treguesit për arsimin e lartë që raportohen nga UNESCO, OECD, EUROSTAT dhe WB

Treguesit	Përshkrimi	UNESCO	OECD	EUROSTAT	WB
Shkalla bruto e regjistrimit	Regjistrimi i përgjithshëm i studentëve pavarësisht nga moshë, i shprehur si përqindje ndaj popullatës që e ka moshën zyrtare e cila korrespondon me nivelin përkatës të arsimit	(X)	(X)	(X)	(X)
Shkalla neto e regjistrimit	Regjistrimi i përgjithshëm i studentëve të grupmoshës zyrtare për nivelin përkatës të studimeve, i shprehur si përqindje ndaj popullatës që e ka moshën zyrtare e cila korrespondon me nivelin përkatës të arsimit	(X)	(X)	(X)	
Numri i studentëve në arsimin e lartë për 100,000 banorë		(X)			
Studentët në arsimin e lartë si përqindje e popullsisë të grupmoshës 20-24 vjeç				(X)	
Përqindja e studentëve në arsimin e lartë sipas niveleve të ISCED	Regjistrimi i studentëve në arsimin e lartë në secilin nivel të ISCED-it 2011, i shprehur si përqindje e numrit të përgjithshëm të studentëve të regjistruar në arsimin e lartë	(X)			
Përqindja e studentëve në arsimin e lartë sipas fushave të studimit të ISCED-F	Regjistrimi i studentëve në arsimin e lartë sipas fushave të studimit të ISCED-F, i shprehur si përqindje e totalit të studentëve të regjistruar në arsimin e lartë	(X)		(X)	
Përqindja e studentëve të regjistruar në arsimin e lartë në institucione private		(X)			(X)
Shpërndarja e studentëve në arsimin e lartë sipas niveleve të ISCED					(X)
Përqindja e studentëve me kohë të pjesshme në arsimin e lartë					(X)
Shkalla e brendshme e mobilitetit	Numri i studentëve nga shtetet tjera që studiojnë në shtetin pritës në raport me numrin e përgjithshëm të studentëve në shtetin pritës	(X)		(X)	(X)
Shkalla e jashtme e mobilitetit	Numri i studentëve nga shteti i origjinës që studiojnë në shtetin pritës në raport me numrin e përgjithshëm të studentëve në shtetin pritës	(X)			(X)
Shpërndarja e studentëve të regjistruar për herë të parë në arsimin e lartë sipas fushave të studimit				(X)	(X)
Përqindja e grave të regjistruara për herë të parë në arsimin e lartë sipas fushave të studimit					(X)
Arritjet në arsimin e lartë – grupmosha 30-34 vjeç	Përqindja e popullsisë të moshës 30-34 vjeç të cilët kanë mbaruar me sukses nivelin e arsimit të lartë.			(X)	
Shkalla bruto e diplomimit	Numri total i të diplomuarve nga niveli i caktuar arsimor pavarësisht moshës, i shprehur si përqindje e popullsisë të moshës tipike të diplomimit për nivelin përkatës	(X)	(X)		

Treguesit	Përshkrimi	UNESCO	OECD	EUROSTAT	WB
Shkalla e përfundimit të shkollimit	Përqindja e studentëve që diplomojnë nga programi i caktuar si përqindje e studentëve që janë regjistruar në atë program aq vite më parë sa është kohëzgjatja e përcaktuar e programit		(X)		
Përqindja e të diplomuarve nga kombinacione të ndryshme të fushave të studimit					(X)
Tregues për të diplomuarit sipas kritereve të ndryshme				(X)	
Përqindja e personelit akademik të gjinisë femërore		(X)			
Raporti student-personel akademik sipas tipit të institucionit			(X)	(X)	
Shpërndarja e grupmoshave të personelit akademik sipas nivelit të ISCED				(X)	
Indeksi i paritetit gjinor	Treguesi përcakton raportin e femrave kundrejt meshkujve për një tregues specifik	(X)	(X)	(X)	(X)
Shpenzimet publike për arsimin e lartë si përqindje e bruto-produktit vendor (BPV)			(X)	(X)	
Shpenzimet private për arsimin e lartë si përqindje e bruto-produktit vendor (BPV)			(X)	(X)	
Përqindja e shpërndarjes së shpenzimeve publike rrjedhëse për arsimin e lartë	Shpenzimet publike rrjedhëse për arsimin e lartë, e shprehur si përqindje e totalit të shpenzimeve publike rrjedhëse për arsim	(X)			
Shpenzimet e Qeverisë për një student si përqindje e BPV për kokë banori	Mesatarja e shpenzimeve (rrjedhëse, kapitale dhe transferimet) të Qeverisë për një student, e shprehur si përqindje e BPV-së për kokë banori.	(X)	(X)	(X)	(X)
Shpenzimet për arsim sipas natyrës së shpenzimeve si përqindje e shpenzimeve totale në institucione publike		(X)			
Përqindja e shpenzimeve rrjedhëse dhe kapitale në raport me shpenzimet totale në arsimin e lartë			(X)		

Burimet: (UNESCO, 2009) (OECD, 2017) (OECD, 2022) (UIS, 2023) (OECD, 2023) (EUROSTAT, 2023b) (World Bank, 2023)

Siç shihet nga tabela, jo të gjithë treguesit raportohen nga të gjitha organizatat. Po ashtu, nga publikimet e statistikave, qofshin ato në formë të bazave të të dhënave ose publikimeve të veçanta vërehet se nuk është e mundur të raportohen treguesit për secilin nga shtetet anëtare të organizatave të lartpërmendura për shkak të mungesës së disa kategorive të të dhënave statistikore për periudha kohore të caktuara.

Në vitet e tetëdhjeta u bë shumë punë në sistemet e treguesve. Pas një periudhe zhvillimi, veçanërisht në vendet e OECD, shumë vende tani posedojnë një sërë treguesish, të quajtur zakonisht “kartelë rezultatesh (scoreboard)” ose “panel” (Martin & Sauvageot, 2011).

4. Të dhënat statistikore në Kosovë dhe krahasimi me vendet fqinje

4.1. Të dhënat statistikore

Republika e Kosovës akoma nuk ka një sistem të qëndrueshëm të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nga fusha e arsimit. Në fushën e arsimit parauniversitar të dhënat mbledhen dhe përpunohen përmes Sistemit për Menaxhimin e Informatave në Arsim (SMIA) ku kanë qasje të drejtpërdrejtë të gjitha institucionet arsimore të nivelit parauniversitar, dhe të cilat i përditësojnë të dhënat e veta në intervale të rregullta kohore. Ky sistem mbështetet në të dhëna kumulative për numrin e nxënësve e jo në të dhëna personale të nxënësve. Nga viti 2018 është në përdorim edhe Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsimin e Lartë (SMIAL), ku institucionet e akredituara të arsimit të lartë regjistrojnë studentët e rinj të të gjitha niveleve. Në fakt, qëllimi i këtij sistemi është përcjellja e regjistrimeve të reja në institucionet e arsimit të lartë me qëllim të mostejkalimit të kuotave të përcaktuara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA). Meqë të dhënat e regjistruara nuk përditësohen, sistemi nuk bën të mundur gjenerimin e statistikave për arsimin e lartë, përveç për studentët e regjistruar për herë të parë në vitin akademik përkatës. Një studim i fizibilitetit i kërkuar nga MASHTI përfundon se “që të mundësohet një pasqyrë unike dhe e qëndrueshme e të dhënave të arsimit të lartë, SMIAL duhet të zhvillohet si sistem i ri me teknologjinë më të fundit dhe që të migrohen të gjitha të dhënat nga SMIAL-i ekzistues në databazën e re” (Tabaku, 2021).

Publikimi i të dhënave për arsimin e lartë ka filluar që në vitet e para pas përfundimit të

luftës në Kosovë. Për herë të parë, të dhënat për studentët dhe për personelin e Universitetit të Prishtinës, janë përfshirë në publikimin e KEC (Hyseni, Shatri, Salihaj, & Pupovci, 2000). Ndërkaq, Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka filluar publikimin e të dhënave për arsimin e lartë në vitin 2004 (ASK, 2004). Në këtë publikim janë përfshirë vetëm të dhënat për Universitetin e Prishtinës, dhe atë:

- Numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë sipas gjinisë dhe njësive akademike;
- Numri i përgjithshëm i studentëve sipas gjinisë dhe njësive akademike;
- Numri i personelit akademik (vetëm totali).

Deri në vitin 2015 ASK dhe MASHTI kanë vazhduar të publikojnë raporte të veçanta statistikore për arsimin. Derisa MASHTI është përqendruar në nivelin e arsimit parauniversitar dhe të dhënat i ka mbledhur përmes SMIA, ASK i ka mbuluar të gjitha nivelet e arsimit, përfshirë edhe atë të arsimit të lartë, ndërsa të dhënat i ka mbledhur përmes pyetësorëve. Përgjashtimisht, të dhënat për arsimin parauniversitar në publikimin e ASK për vitin 2014/15 janë marrë nga sistemi SMIA i MASHTI-t (ASK, 2015).

Deri në vitin 2015 të dhënat për arsimin e lartë janë raportuar vetëm për universitete publike, ndërsa në publikimin e vitit 2016 për herë të parë u përfshinë edhe të dhënat për kolegjet private (MASHT-ASK, 2016). Ky edhe është publikimi i parë i përbashkët i të dhënave

statistikore për arsimin i MASHTI-t dhe ASK-së, praktikë e publikimeve, e cila ka vazhduar deri në ditët e sotme. MASHTI e bën mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për arsimin parauniversitar duke shfrytëzuar sistemin SMIA, ndërsa ASK i mbledh të dhënat për arsimin e lartë nga institucionet përkatëse, përmes pyetësorëve. Vitet e fundit, këto të dhëna mblidhen përmes ueb aplikacionit CAWI (“Computer-Assisted Web Interviewing”), një platformë online e përdorur për mbledhjen e të dhënave nëpërmjet anketave.

Përgjatë këtyre viteve, struktura e të dhënave të raportuara ka pësuar ndryshime, ndërkaq në publikimin e fundit të të dhënave statistikore (MASHTI-ASK, 2022) figurojnë të dhënat vijuese për institucionet publike dhe private të arsimit të lartë:

- Numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë të nivelit Bachelor/Master sipas nivelit të studimeve dhe gjinisë;
- Numri i përgjithshëm i studentëve në nivelin Bachelor/Master sipas nivelit të studimeve, gjinisë dhe vitit të studimit;
- Numri i përgjithshëm i studentëve nga jashtë vendit në nivelin Bachelor/Master sipas nivelit të studimeve, vendit të origjinës dhe gjinisë;
- Numri i studentëve të diplomuar në nivelin Bachelor/Master sipas nivelit të studimeve dhe gjinisë;
- Numri i personelit akademik sipas gjinisë;
- Numri i personelit akademik nga jashtë vendit dhe sipas gjinisë.

Po ashtu, prezantohen të dhëna edhe për studime të doktoratës, të cilat aktualisht ofrohen vetëm nga Universiteti i Prishtinës:

- Numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë të studimeve të doktoratës sipas programit të studimit dhe të gjinisë;
- Numri i përgjithshëm i studentëve të doktoratës sipas programit të studimit, të gjinisë; dhe vitit të studimit;
- Numri i studentëve të diplomuar të doktoratës sipas programit të studimit dhe të gjinisë.

Të dhënat sipas viteve mund të gjenden në bazën e të dhënave të ASK (ASK, 2023).

4.2. Të dhënat statistikore në burim

Në mungesë të një sistemi të digjitalizuar për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për gjithë sektorin e arsimit të lartë në Kosovë, institucionet kompetente përdorin metoda të ndryshme për mbledhjen dhe për përpunimin e të dhënave. Këtu do t'i trajtojmë të dhënat që mblidhen nga tri institucione: Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), dhe Universiteti i Prishtinës.

4.2.1. Agjencia e Statistikave e Kosovës

Siç u sqarua më sipër, ASK i mbledh të dhënat nga institucionet e arsimit të lartë në Kosovë përmes një pyetësori, i cili plotësohet nga institucionet duke shfrytëzuar aplikacionin për sondazhe CAWI. Pyetësori i ASK-së¹ është i ndarë në 6 seksione:

- 1 Të dhënat e universitetit/kolegjit: Bëhet fjalë kryesisht për të dhënat që ndërlidhen me lokacionin dhe me informacionet e kontaktit.

¹ Pyetësori është i zbatuar në aplikacionin CAWI, ndërsa autorëve u është vënë në dispozicion, nga stafi përgjegjës i ASK, dokumenti me pyetësorin për vitin akademik 2022/23 në formatin PDF më 3 shkurt 2023.

- 2** Niveli Bachelor: Në këtë seksion mblidhen të dhëna për numrin e studentëve. Një pjesë e të dhënave mblidhen në nivel të universitetit/kolegjit, ndërsa një pjesë tjetër në nivel të programeve të studimit/njesisë akademike:
- Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë sipas gjinisë (në nivel të programit të studimit);
 - Numri i studentëve të regjistruar sipas viteve të studimit dhe sipas gjinisë (në nivel të programit të studimit);
 - Numri i studentëve të regjistruar sipas përkatësisë etnike dhe sipas gjinisë (në nivel të universitetit/kolegjit);
 - Numri i studentëve të regjistruar nga jashtë vendit sipas vendit të origjinës dhe sipas gjinisë (në nivel të universitetit/kolegjit);
 - Numri i studentëve të diplomuar sipas gjinisë (në nivel të programit të studimit);
- 3** Niveli Master: Kërkohen të dhënat e njëjta si për nivelin Bachelor.
- 4** Stafi akademik dhe administrativ – niveli Bachelor dhe Master. Edhe këtu një pjesë e të dhënave mblidhen në nivel të universitetit/kolegjit, ndërsa një pjesë tjetër në nivel të programeve të studimit/njesisë akademike:
- Stafi sipas statusit (i rregullt, i angazhuar, staf administrativ) sipas gjinisë (në nivel të programit të studimit);
 - Stafi akademik sipas përkatësisë etnike dhe sipas gjinisë (në nivel të universitetit/kolegjit);
 - Stafi akademik nga jashtë vendit sipas vendit të origjinës dhe sipas gjinisë (në nivel të universitetit/kolegjit);
- 5** Niveli i Doktoratës: Ngjashëm si për nivelin Bachelor dhe Master, porse kërkohen më pak të dhëna:
- Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë sipas gjinisë (në nivel të programit të studimit);
 - Numri i studentëve të regjistruar sipas viteve të studimit dhe sipas gjinisë (në nivel të programit të studimit);
 - Numri i studentëve të diplomuar sipas gjinisë (në nivel të programit të studimit);
- 6** Stafi akademik dhe administrativ – niveli i doktoratës.:
- Stafi sipas statusit (i rregullt, i angazhuar, staf administrativ) sipas gjinisë (në nivel të programit të studimit);

Vërehet që përmes këtij pyetësori nuk mund të mblidhen të gjitha të dhënat për arsimin e lartë që kërkohen me standardet e përcaktuara nga UNESCO, OECD dhe EUROSTAT.

4.2.2. MASHTI

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Arsimin e Lartë (SMIAL) u zhvillua për herë të parë në vitin 2018 dhe i njëjti shfrytëzohet për grumbullimin dhe monitorimin e të dhënave në arsimin e lartë ku institucionet e arsimit të lartë (IAL) të akredituara dhe të licencuara në Kosovë bëjnë regjistrimin e studentëve në nivelet Bachelor, Master dhe Doktoratë sipas afateve të përcaktuara në legjislacion (Tabaku, 2021).

Softueri, i cili përbëhet nga 4 module mundëson regjistrimin e të dhënave për IAL-të, si dhe për programet e studimit e studentët. Të dhënat për studentët që përfshihen në sistem janë: numri personal, emri, emri i prindit, mbiemri, data e lindjes, gjinia,

shteti i lindjes, vendi i lindjes, adresa e banimit, komuna, përkatësia etnike, fakulteti, viti i studimit, programi i studimit, niveli i studimit dhe gjuha e studimit. Sipas procedurave të përcaktuara, në sistem regjistrohen vetëm studentët të cilët fillojnë studimet në ndonjërin nga programet e niveleve Bachelor, Master dhe Doktoratë, ku përfshihen studentët që regjistrojnë vitin e parë, por edhe ata që transferohen nga programet tjera në vite më të larta të studimeve.

Në fillim të vitit akademik nga të gjitha institucionet e akredituara të arsimit të lartë kërkohet që në sistem t'i vendosin të dhënat për studentët e rinj, sipas programeve dhe duke respektuar kuotat e përcaktuara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës.

Dedikimi primar i këtij softueri nuk është mbledhja dhe përpunimi i të dhënave statistikore, por kontrollimi i respektimit të kuotave të studentëve që përcaktohen nga Agjencia e Kosovës për Akreditim. Prandaj, sistemi nuk mbledh të dhëna për progresin e studentëve që tanimë vijnë në një program të caktuar. Megjithatë, nga sistemi mund të nxirren disa të dhëna statistikore për studentët që kanë regjistruar studimet për herë të parë.

4.2.3. Universiteti i Prishtinës

Universiteti i Prishtinës përdor Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS), i cili përmban të gjitha të dhënat relevante për studentët, duke filluar nga ato personale deri te të dhënat për progresin e studimeve. Një sistem i tillë mund t'i gjenerojë të gjitha të dhënat relevante për studentët e Universitetit. Sisteme të ngjashme kanë edhe universitetet tjera publike, ndërkaq kolegjet private kanë sisteme autonome të cilat u shërbejnë nevojave të tyre.

Të dhënat statistikore për numrin e studentëve të regjistruar në vitin akademik aktual janë në dispozicion të publikut sipas njësive akademike, dhe sipas nivelit të studi-

meve e programit të studimit (Universiteti i Prishtinës, 2023). Ndërkaq, shërbimi përkatës i Universitetit gjeneron të dhëna për nevojat e organeve të Universitetit.

4.3. Treguesit

Korniza e parë e treguesve të arsimit për Kosovën u hartua dhe u botua për herë të parë në vitin 2010 (MASHT, 2010). Kjo Kornizë mbështetet në dokumentet relevante të UNESCO-s, të vendeve të OECD-së, e që korrespondonin edhe me treguesit e përgjithshëm të "Arsimit për të gjithë", një nismë globale për gjithëpërfshirje e cilësi në arsim e cila u realizua në periudhën 1990-2015. Në vitin 2017, kjo Kornizë u rishikua e u saktësua duke ndjekur udhëzimet teknike të UNESCO-s (UNESCO, 2009). Në versionin e ri të Kornizës (MASHT, 2017) janë përfshirë edhe tregues specifikë për arsimin e lartë:

- 1 Shkalla bruto e regjistrimit;
- 2 Shkalla neto e regjistrimit;
- 3 Numri i studentëve në arsimin e lartë për 100,000 banorë;
- 4 Përqindja e studentëve në arsimin e lartë sipas niveleve të ISCED;
- 5 Përqindja e studentëve në arsimin e lartë sipas fushave të studimit të ISCED-F;
- 6 Indeksi i paritetit gjinor;
- 7 Përqindja e shpërndarjes së shpenzimeve publike rrjedhëse për arsimin e lartë;
- 8 Shpenzimet e Qeverisë për një student si përqindje e BPV për kokë banori.

MASHTI ka filluar praktikën e publikimit të treguesve për arsim nga viti shkollor 2009/10. Në publikimin e parë për vitet shkollore 2009/10-2011/12 (MASHT, 2012) janë përfshirë edhe disa tregues të arsimit të lartë:

- Përqindja e studentëve në universitetet publike sipas niveleve;
- Përqindja e studenteve femra në universitetet publike sipas niveleve;
- Përqindja e studentëve në arsimin e lartë sipas fushave të studimit (ISCED-F akoma nuk ka qenë në fuqi në atë kohë);
- Përqindja e studentëve të diplomuar në arsimin e lartë sipas fushave të studimit (ISCED-F akoma nuk ka qenë në fuqi në atë kohë);
- Përqindja e studentëve në universitetet private sipas niveleve;
- Përqindja e studenteve femra në universitetet private sipas niveleve;
- Përqindja e studentëve në universitetet private krahasuar me universitetet publike, sipas niveleve;
- Numri i studentëve në arsimin e lartë për 100,000 banorë;

Ndërkaq, në publikimin e radhës për vitet 2012/13-2013/14 (MASHT, 2014) dhe në ato të mëvonshme janë përfshirë vetëm tregues për arsimin parauniversitar që janë të krahasueshëm me tregues ndërkombëtarë. Duke filluar nga viti 2015 treguesit publikohen rëndom në fund të vitit kalendarik për vitin shkollor paraparak (MASHTI, 2022c).

Ndërkaq, publikimi i parë që përqendrohet në treguesit e arsimit të lartë është i nëntorit të vitit 2022 dhe sjell të dhëna për statistikat e arsimit të lartë sipas fushave të studimit për vitin akademik 2021/2022, pikërisht për treguesin 5 nga lista e mësipërme (ASK, 2022a).

Sipas hartës së rrugës së ASK një pasqyrë e ngjashme e treguesve për vitin akademik 2022/23 parashihet të publikohet në tetorin e vitit 2023 (ASK, 2022b).

4.4. Përvojat nga vendet fqinje

Si pjesë e këtij hulumtimi, u analizuan përvojat e vendeve fqinje në mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave për arsimin e lartë. Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia janë vende kandidatë për Bashkimin Evropian dhe anëtare të UNE-SCO-s, prandaj, si rregull, të dhënat e tyre raportohen nga EUROSTAT dhe UNESCO. Me gjithë faktin se metodologjia e mbledhjes dhe e përpunimit të të dhënave nuk është plotësisht në harmoni me standardet e këtyre dy organizatave, sërish ato janë në gjendje të nxjerrin një numër të konsiderueshëm të treguesve për këto vende.

Përveç kësaj, institucionet përkatëse të vendeve fqinje publikojnë të dhëna edhe në uebfaqet e tyre.

Shqipëria



Autoriteti kompetent për statistika është Instituti i Statistikave (INSTAT) i cili publikon të dhëna për arsimin e lartë (INSTAT, 2022a) (INSTAT, 2022b):

- Numri i studentëve në arsimin e lartë sipas tipit të institucionit dhe sipas gjinisë;
- Numri i studentëve në arsimin e lartë sipas nivelit arsimor dhe sipas gjinisë;
- Numri i studentëve në arsimin e lartë sipas fushave të studimit;
- Numri i të diplomuarve në arsimin e lartë sipas nivelit arsimor dhe sipas gjinisë;
- Numri i të diplomuarve në arsimin e lartë sipas fushave të studimit dhe sipas gjinisë.

Ndërkaq, të dhëna më të detajuara publikohen në vjetarët statistikorë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS, 2022), si dhe në bazën e të dhënave të INSTAT (INSTAT, 2023).

Maqedonia e Veriut



Enti Shtetëror i Statistikës (MAKSTAT) mbledh të dhëna përmes raporteve individuale statistikore që plotësohen me rastin e regjistrimit të studentëve, përkatësisht diplomimit të tyre e ku po ashtu, jepen të dhëna për personelin akademik. Të dhënat raportohen përmes publikimeve, por edhe në bazën e të dhënave, e cila është publike (MAKSTAT, 2023). Të dhënat janë mjaftueshëm të detajuara dhe bëjnë të mundur kalkulimin e treguesve të shumtë, disa prej të cilëve raportohen edhe në publikimet e rregullta statistikore.

Mali i Zi



Mbledhja e të dhënave bëhet përmes raporteve individuale statistikore nga Drejtoria për Statistikë (MONSTAT), e cila e bën publikimin e të dhënave në raporte të veçanta periodike, si dhe në bazën e të dhënave (MONSTAT, 2023). Megjithatë, të dhënat që publikohen janë mjaft të kufizuara nga aspekti i llojllojshmërisë së tyre dhe nuk mundësojnë kalkulimin e shumë treguesve.

Serbia



Autoriteti kompetent është Enti Republikan i Statistikës (RZS) i cili publikon të dhënat për arsimin e lartë në baza vjetore duke prodhuar raporte mjaft gjithëpërfshirëse dhe me shumë llojshmëri kriteresh (RZS, 2022). Po ashtu, të dhënat publikohen edhe në bazën e të dhënave (RZS, 2023).

5. Sfidat kryesore të statistikave të arsimit të lartë në Kosovë

Të dhënat statistikore të plota dhe cilësore janë thelbësore për të ndjekur progresin dhe për të marrë vendime të informuara në fushën e arsimit të lartë. Procesi i mbledhjes, përpunimit, publikimit dhe shfrytëzimit të të dhënave statistikore përballet me sfida të shumta që ndërlidhen me legjislacionin dhe politikat, çështjet organizative, kapacitetet teknike e njerëzore, si dhe koordinimin ndërinstytucional. Në këtë kapitull përshkruhen disa nga këto sfida në bazë të informatave të mbledhura nga burimet ekzistuese dhe intervistat e zhvilluara me zyrtarë kompetentë të MASHTI, ASK, institucioneve të arsimit të lartë dhe ekspertë të arsimit.

5.1. Politikat dhe legjislacioni

Ligji për Statistikat Zyrtare i plotësuar dhe i ndryshuar (Ligji Nr. 04/L-036, 2011) (Ligji Nr. 06/L-058, 2018) përcakton ASK-në si bartësin kryesor të statistikave zyrtare në Kosovë. ASK koordinon sistemin shtetëror të statistikave dhe siguron harmonizimin e të dhënave statistikore. Që të sigurohet një koordinim më i mirë ndërinstytucional është formuar Këshilli Statistikor, si trup këshillëdhënës, ku përfaqësohen ministritë dhe agjencitë nga fushëveprimi i të cilave mbledhen të dhëna statistikore, si dhe institucionet akademike, komuniteti i biznesit dhe shoqëria civile.

Një ndër obligimet ligjore të ASK-së është të përgatisë projektin e Programit të Statistikave Zyrtare i cili siguron kornizën për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare në Kosovë. Ky program është 5

vjeçar dhe aprovohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Programi përfshin hulumtimet statistikore, të nevojshme për sigurimin e të dhënave dhe përcakton autoritetet publike (ministritë, agjencitë, etj.) kompetente për mbledhjen e të dhënave statistikore të caktuara. Programi i Statistikave Zyrtare 2018-2022 autorizon MASHT-in “për të regjistruar numrin i shkollave, nxënësve dhe mësuesve në çdo nivel arsimor” (ASK, 2017). Programi parasheh publikimin e rregullt vjetor të statistikave të arsimit pa specifikuar përmbajtjen e tyre. Ndërkaq, si produkt i ri nga fusha e arsimit identifikohet Anketat për arsimimin e të rriturve, e cila ishte në plan të realizohej në vitin 2021, por nuk është realizuar akoma. E njëjta është përfshirë në planin për vitin 2023 bashkë me publikimin e të dhënave të arsimit sipas klasifikimit ISCED 2011 dhe klasifikimit të fushave të studimit ISCED F 2013 (ASK, 2022b).

Raporti i progresit të BE-së për Kosovën në fushën e statistikave tregon se Kosova ka bërë disa përmirësime në periudhën e raportimit, por duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme në shumë fusha (European Commission, 2022). Nga ASK pritet të shtojë numrin e produkteve statistikore dhe të përmirësojë koordinimin dhe qasjen në burimet e të dhënave administrative. Në fushën e statistikave sociale, raporti konstaton se Kosova nuk ka arritur të ofrojë statistika të plota dhe të rregullta për të gjitha fushat e nevojshme. Në fushën e arsimit konstatohet se të dhënat janë të pjesshme në raport me standardet ndërkombëtare, si dhe nuk janë plotësisht të klasifikuara sipas ISCED 2011. Megjithatë, përditë-

simi i tyre bëhet me rregull, ndërsa fakti se të dhënat demografike nuk janë të përditësuara shihet si pengesë për prodhimin e statistikave cilësore edhe në fushën e arsimit.

Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit “parasheh zhvillimin e një sistemi statistikor efikas dhe të qëndrueshëm në Kosovë të aftë për të siguruar të dhëna të besueshme, objektive dhe të sakta, të krahasueshme me statistikave evropiane, që nevojiten për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe të reformës në Kosovë” (Qeveria e RKS, 2022). Për këtë arsye, sistemi i statistikave është kapitull i veçantë i Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA) 2022-2026 (Qeveria e RKS, 2022). PKZMSA 2022-2026 parasheh masa të veçanta për fuqizimin e ASK-së dhe përmirësimin e cilësisë e të vëllimit të statistikave zyrtare. Në mesin e këtyre masave dallojmë përpjekjet për përmirësimin e koordinimit midis institucioneve kryesore për të dhëna statistikore që nënkupton rritjen e numrit të burimeve administrative të të dhënave, si dhe rritjen e numrit e të mbulueshmërinë e publikimeve statistikore.

Zbatimi i legjislacionit dhe i politikave në praktikë është një kapitull i veçantë. Edhe pse me status të përcaktuar ligjor të institucionit përgjegjës për statistika zyrtare, ASK ka probleme në komunikim me institucionet që duhet ta furnizojnë me të dhëna statistikore. Nga PSZ 2018-2022 dhe bashkëbisedimi me zyrtarët në ASK kuptohet se ASK nuk ka qasje në sistemet SMIA dhe SMIAL, të cilët menaxhohen nga MASHTI. Sigurimi i qasjes në këto dy sisteme është një nga aktivitetet e planifikuara, por të përfunduar deri më tani, të PSZ 2018-2022. Gjithashtu, ASK-ja ka vështirësi të konsiderueshme për mbledhjen e të dhënave nga IAL-të, të cilat nuk u përgjigjen kërkesave të saj gjithnjë. Raportohet se një arsye për këtë mund të jetë mungesa e koordinimit institucional, pasi të dhënat nga IAL-të kërkohen në periudha dhe për qëllime të ndryshme, nga ASK, MASHTI dhe AKA, ndërkohë që tri institucionet e përmendura nuk i shkëmbejnë ato në mes vete.

Legjislacioni parasheh dispozita ndëshkuese për personat juridikë dhe fizikë që cenojnë mbarëvajtjen e punës gjatë mbledhjes së të dhënave statistikore, por nga intervistat e zhvilluara kemi mësuar se ato nuk zbatohen në praktikë. Është raportuar se, në të kaluarën e afërt, disa institucione të arsimit të lartë nuk i janë përgjigjur kërkesave të ASK-së për dorëzimin e të dhënave statistikore dhe se ky problem është tejkaluar me ndërhyrjen e AKA-së dhe MASHTI-t.

5.2. Cilësia dhe harmonizimi me standarde ndërkombëtare

Ligji për Statistikat Zyrtare (Ligji Nr. 04/L-036, 2011) përcakton kriteret për statistika cilësore: relevanca, saktësia, afatet, përpikëria, qasja dhe qartësia, krahasueshmëria, dhe koherenca. ASK është përgjegjëse që metodologjitë statistikore të përdorura në Kosovë të jenë të përafërta me ato që përdoren në vendet e tjera në rajon dhe në Evropë. Që të jetë në gjendje të zbatojë këto objektiva, ASK, në mënyrë të vazhdueshme përditëson procedurat e veta të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave. Megjithatë, për cilësinë e statistikave që prodhohen në Kosovë dhe për harmonizimin e tyre me standardet ndërkombëtare flitet me tone kritike.

Të gjithë bashkëbiseduesit tonë pajtohen se cilësia e statistikave të arsimit të lartë në Kosovë lë shumë për të dëshiruar. Vetë procesi i mbledhjes së të dhënave është i fragmentuar. Përderisa, MASHTI mbledh të dhëna vetëm për regjistrimet e reja përmes sistemit SMIAL, ASK-ja mbledh të dhëna përmes pyetësorëve në baza vjetore. Ndërkaq, AKA-ja mbledh të dhëna vetëm me rastin e akreditimit të programeve, ndërkohë që nuk ka asnjë lloj shkëmbimi të të dhënave në mes të tri institucioneve. Bashkëbiseduesit identifikojnë dy shkaqe kryesore për cilësinë jo të kënaqshme të statistikave të arsimit të lartë:

- 1 Mungesa e një sistemi funksional elektronik i cili do të siguronte që statistikave të jenë të plota dhe të përditësuara, në përputhje me standardet; dhe
- 2 Kapacitetet njerëzore të pamjaftueshme për mbledhjen dhe përpunimin cilësor të të dhënave statistikore.

Ekziston një konsensus i përgjithshëm se statistikave të arsimit të lartë nuk janë në harmoni me standardet ndërkombëtare. Këtë e konfirmon edhe raporti i progresit, ku theksohet se, nga statistikave sociale, vetëm ato demografike janë në linjë me kërkesat e Aquis (European Commission, 2022). Një pjesë e mirë e të dhënave statistikore për arsimin e lartë mungojnë në tërësi, p.sh. nuk mbledhen të dhënat për moshën e studentëve, e të ngjashme. Ndërkaq, disa të dhëna nuk janë aspak në harmoni me standardet ndërkombëtare. Këtu po e sjellim një shembull nga pyetësi i ASK-së për institucionet e arsimit të lartë ku kërkohen të dhëna për stafin e institucioneve të arsimit të lartë sipas statusit (i rregullt, i angazhuar, staf administrativ) sipas gjinisë (në nivel të programit të studimit). Të dhënat e mbledhura në këtë formë mund të jenë çorientuese, pasi stafi akademik dhe administrativ në institucione të arsimit të lartë rëndom kontribuojnë në disa programe. Për këtë arsye, edhe udhëzuesi përkatës i UOE (2022) kërkon që, në raste të tilla, ngarkesa e stafit të pjesëtohet sipas programeve respektivisht niveleve të arsimit që të shmangen dyfishimet dhe të mund të nxirren përfundime për stafin në nivel të programeve, respektivisht niveleve. Sipas bashkëbiseduesve tanë, ASK është e familjarizuar me standardin UOE dhe raporton me rregull në EUROSTAT, por nuk ka burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale për përmbushjen e kërkesave për statistika, në harmoni me standardet ndërkombëtare.

5.3. Shfrytëzimi i të dhënave për vendimmarrje

Bashkëbiseduesit tanë konfirmojnë se shfrytëzimi i statistikave të arsimit të lartë për vendimmarrje është mjaft i kufizuar dhe kjo ndodh për shkak të mungesës së të dhënave statistikore dhe defekteve të tyre. Si problem shihet fakti se të dhënat nuk janë të plota, nuk janë të segreguara sa duhet, si dhe nuk lidhen me të dhënat nga tregu i punës. AKA është ndër institucionet që i shfrytëzojnë statistikave për përcaktimin e trendëve të regjistrimit të studentëve me rastin e marrjes së vendimeve për akreditimin e programeve të studimeve.

Mungesa e treguesve për arsimin e lartë është një handicap serioz për shfrytëzimin e të dhënave statistikore në procesin e vendimmarrjes. Siç është shpjeguar në seksionin 4.3 të këtij raporti, tetë tregues për arsimin e lartë tanimë janë pjesë e Kornizës së treguesve të arsimit, por asnjëri prej tyre nuk raportohet.

6. Hapat në vazhdim – mundësitë për adresimin e problemit

Defektet evidente në statistikat e arsimit të lartë në Kosovë duhet adresuar në mënyrë sistematike. Në radhë të parë duhet përcaktuar kërkesat për të dhëna statistikore, në mënyrë që ato të jenë në harmoni me standardet e pranura ndërkombëtare dhe të rezultojnë me informacion relevant për të gjitha palët me interes. Pastaj, duhet menduar për sistemet për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, të cilat bëjnë të mundur që të dhënat statistikore të ruhen dhe të shfrytëzohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Është me rëndësi të zhvillohet edhe një paketë e treguesve kombëtarë për arsimin e lartë, ndërsa treguesit e përfshirë në kornizën aktuale të treguesve (MASHT, 2017) mund të shërbejnë si një pikënisje e mirë. Dhe, në fund duhet përcaktuar nevojat për kapacitete të reja, si dhe për ndarjen e detyrave dhe të përgjegjësisive në mes të institucioneve kompetente për statistika në arsimin e lartë, në radhë të parë MASHTI dhe ASK.

6.1. Përcaktimi i kërkesave për të dhëna

Që të sigurohen statistika cilësore dhe të krahasueshme për arsimin e lartë duhet përcaktuar qartë kërkesat për të dhëna statistikore. Me këtë rast, si pikënisje mund të shërbejë Manuali i përbashkët i UNESCO, OECD dhe EUROSTAT (UOE, 2022) i cili përcakton një gamë të gjerë të të dhënave që kërkohen nga të tria organizatat. Këto të dhëna mund të ndahen në tri grupe: të dhënat për studentët (ENRL, ENTR dhe GRAD), të dhëna

për personelin akademik (PERS) dhe të dhëna për shpenzimet (FIN). Këtu bëhet fjalë për setet minimale të të dhënave dhe është e dëshirueshme të mblidhen edhe të dhëna të tjera, nëse ka mundësi.

6.1.1. Të dhënat për studentët

Në kontekstin e Kosovës, njësia themelore për të cilën mblidhen të dhënat për studentët është programi i studimeve. Në vitin akademik 2022/23 në Kosovë janë gjithsej 395 programe studimi të niveleve ISCED 6-8 të akredituara nga AKA (AKA, 2023). Programet e nivelit ISCED 5 akreditohen nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) dhe në vitin akademik 2022/23 janë gjithsej 33 programe që ofrohen nga 12 institucione të ndryshme (AKK, 2023). Përveç këtyre programeve, mund të ketë edhe programe të tjera që nuk janë ri-akredituar, por që vazhdojnë punën me studentë deri në skadimin e afatit ligjor për përfundimin e studimeve.

Nëse të dhënat për studentë mblidhen sipas programeve, për secilin/ën prej tyre duhet kërkuar nga institucioni raportues kodin 3-shifror të ISCED 2011 dhe kodin 4-shifror të ISCED-F-2013, prej të cilëve pastaj rrjedhin kodet përkatëse me më pak shifra. Klasifikimi i të dhënave sipas tipit të institucionit nuk paraqet vështirësi, pasi në Kosovë institucionet e arsimit të lartë janë publike ose private (nëntipi: të pavarura).

Tabela 3 jep një shembull të setit të të dhënave për studentë, i cili, në masë të madhe korrespondon me kërkesat e UOE (2022). Siç shihet nga tabela 3, për secilën nga tri kategoritë e të dhënave për studentë sipas UOE (2022) - studentët e regjistruar (ENRL), studentët e regjistruar për herë të parë (ENTR)

dhe të diplomuarit (GRAD) - kërkohen të dhënat vijuese:

- numri sipas moshës dhe gjinisë;
- numri i shtetasve të huaj sipas moshës dhe gjinisë;
- numri sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë.

TABELA 3. Kërkesat e mundshme për të dhënat statistikore për studentë sipas programeve të studimeve

Të dhënat	Ndërlidhja me të dhënat sipas UOE(2022) nga tabela 1	Komente
Studentët e regjistruar (ENRL)		
Numri i studentëve sipas moshës dhe gjinisë	ENRL1A-INST ENRL2-AGE&P ENRL4-FIELD	Mosha deri në 49 vjeç duhet të shprehet në vite të vetme, pastaj në grupmosha 50-54, 55-59, 60-64, 65+ dhe “e panjohur”.
Numri i studentëve shtetas të huaj sipas vendit të origjinës dhe gjinisë	ENRL5-MOB&FIELD ENRL6-MOB&COUNTRY	Për vendin e origjinës shfrytëzohen kodet me dy simbole të përcaktuara me standardin ISO 3166-1.
Numri i studentëve sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë		Këto të dhëna nuk kërkohen nga institucionet ndërkombëtare si UNESCO, OECD dhe EUROSTAT, por janë me interes për kontekstin e Kosovës.
Studentët e regjistruar për herë të parë (ENTR)		
Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë sipas moshës dhe gjinisë	ENTR1-AGE ENTR3-FIELD	Mosha deri në 49 vjeç duhet të shprehet në vite të vetme, pastaj në grupmosha 50-54, 55-59, 60-64, 65+ dhe “e panjohur”.
Numri i studentëve shtetas të huaj të regjistruar për herë të parë sipas moshës dhe gjinisë	ENTR2-MOBILE&AGE	Për vendin e origjinës shfrytëzohen kodet me dy simbole të përcaktuara me standardin ISO 3166-1.
Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë		Këto të dhëna nuk kërkohen nga institucionet ndërkombëtare si UNESCO, OECD dhe EUROSTAT, por janë me interes për kontekstin e Kosovës.
Të diplomuarit (GRAD)		
Numri i të diplomuarve sipas moshës dhe gjinisë	GRAD1-INST GRAD2-AGE GRAD5-FIELD	Mosha deri në 49 vjeç duhet të shprehet në vite të vetme, pastaj në grupmosha 50-54, 55-59, 60-64, 65+ dhe “e panjohur”.

Të dhënat	Ndërlidhja me të dhënat sipas UOE(2022) nga tabela 1	Komente
Numri i të diplomuarve shtetas të huaj sipas vendit të origjinës dhe gjinisë	GRAD6-MOB&FIELD GRAD7-MOB&COUNTRY	Për vendin e origjinës shfrytëzohen kodet me dy simbole të përcaktuara me standardin ISO 3166-1.
Numri i të diplomuarve sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë		Këto të dhëna nuk kërkohen nga institucionet ndërkombëtare si UNESCO, OECD dhe EUROSTAT, por janë me interes për kontekstin e Kosovës.

Në rast të pamundësisë për raportimin e të dhënave sipas viteve të vetme të moshës përjashtohen kategoritë ENRL2-AGE&P, EN-TR1-AGE dhe GRAD2-AGE të kërkuara me UOE (2022), ndërsa cungohet kategoria EN-TR2-MOBILE&AGE. Për shkak të specifikave të sistemit arsimor të Kosovës nuk mund të kërkohen të dhëna për kategorinë “EN-RL3-AGE&P - Numri i studentëve me kohë të pjesshme sipas moshës dhe gjinisë”, sepse studimet me kohë të pjesshme nuk organizohen. Po ashtu, është e vështirë të sigurohen të dhëna për studentët e diplomuar për herë të parë, pasi institucionet e arsimit të lartë mund të mos i kenë këto informata, prandaj përjashtohen edhe kategoritë GRAD3-FIRST&AGE dhe GRAD4-MOB&AGE nga UOE (2022).

Ndërkaq, numri i studentëve, i studentëve të regjistruar për herë të parë dhe i të diplomuarve, sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë, kërkohet për shkak të specifikave të kontekstit të Kosovës, edhe pse nuk përfshihet në kërkesat e UOE (2022).

6.1.2. Të dhënat për personelin akademik

Sipas përkufizimeve në Udhëzuesin UOE (2022) personel akademik konsiderohen të gjithë të punësuarit në institucione të arsimit të lartë që detyrë primare e kanë mësimdhënien ose hulumtimin, përfshirë edhe

personelin që mbajnë pozita menaxhuese akademike si rektor, dekan, prodekan, shef i departamentit, etj.

Përderisa është e arsyeshme që të dhënat për studentë të mblidhen sipas programeve të studimeve, kjo nuk vlen për të dhënat e personelit akademik, sepse personeli akademik rëndom angazhohet në disa programe dhe në nivele të ndryshme të studimit. Prandaj, të dhënat për personelin akademik mblidhen në nivel të institucionit të arsimit të lartë. Udhëzuesi UOE (2022) parasheh 3 kategori të të dhënave për personelin akademik.

PERS1-STUD: Numri i studentëve i përshtatur për personelin akademik sipas nivelit arsimor, orientimit programor, tipit të institucionit dhe kohës së studimit.

Në kontekstin kosovar niveli arsimor (ISCED 5-8) jep informacion edhe për orientimin programor, pasi programet e nivelit ISCED 5 janë profesionale, ndërsa ato të nivelit ISCED 6-8 akademike. Tipi i institucionit (publik ose privat) mund të derivohet nga vetë institucioni që ofron të dhëna, ndërsa koha e studimit mund të jetë vetëm një – e plotë – pasi studime me kohë të pjesshme nuk organizohen. Për këtë arsye, të dhënat e mbledhura për numrin e përgjithshëm të studentëve sipas programeve të studimit nuk kanë nevojë për asnjë lloj përshtatje dhe mund të shërbejnë si të dhëna për kategorinë PERS1-STUD.

PERS2-INST: Personeli akademik sipas tipit të institucionit, ngarkesës me punë dhe gjinisë

Të dhënat raportohen në nivel të institucionit i cili mund të jetë publik ose privat (tipi i institucionit). Sa i përket ngarkesës, sipas Udhëzuesit UOE (2022) për secilin anëtar të personelit akademik duhet të përcaktohet përqindja e ngarkesës në raport me ngarkesën e personelit me kohë të plotë. Për shembull, profesori që mban 4 orë mësimi në javë nga 6 orë sa është ngarkesa tipike e personelit, konsiderohet se ka ngarkesë prej 0.67 (67%) dhe kjo njësi, në terminologjinë e UOE (2022)

quhet *full-time equivalent* (FTE). Nëse anëtari i personelit akademik ka 90% ose më shumë ngarkesë, atëherë konsiderohet se është me orar të plotë (*full-time*), përndryshe konsiderohet se është me orar të pjesshëm (*part-time*). Në rastin e PERS2-INST të dhënat duhet të raportohen për të dyja gjinitë (femra dhe meshkuj) në të ndara në personel me orar të plotë dhe të pjesshëm, si dhe totali i tyre. Po ashtu, duhet të raportohen në formë të shumës së ngarkesave të personelit (gjithsej FTE). Kjo është ilustruar në tabelën 4.

TABELA 4. Të dhënat për PERS2-INST

Femra	Me orar të plotë
	Me orar të pjesshëm
	Gjithsej me orar të plotë dhe të pjesshëm
	Gjithsej FTE
Meshkuj	Me orar të plotë
	Me orar të pjesshëm
	Gjithsej me orar të plotë dhe të pjesshëm
	Gjithsej FTE
Gjithsej Femra dhe Meshkuj	Me orar të plotë
	Me orar të pjesshëm
	Gjithsej me orar të plotë dhe të pjesshëm
	Gjithsej FTE

PERS3-AGE: Personeli akademik sipas nivelit arsimor, orientimit programor, gjinisë dhe moshës

Raportimi sipas nivelit arsimor bëhet duke dalluar institucionet që ofrojnë programe të nivelit ISCED 6-8 dhe ISCED 5.

Në kontekstin kosovar, kjo ndarje përcakton edhe orientimin programor, sepse institucionet që ofrojnë programe të nivelit ISCED 6-8 konsiderohen akademike, ndërsa ato që ofrojnë programe të nivelit ISCED 5 – profesionale. Sipas Udhëzuesit UOE (2022)

kërkohej raportimi i numrit të përgjithshëm të personelit akademik, të zëbërthyer sipas gjinisë dhe sipas grupmoshave <25, 25-29, 30-34, 35-39, 40-44, 45-49, 50-54, 55-59, 60-64, 65+ dhe “mosha e panjohur”.

6.1.3. Të dhënat për shpenzimet

Mbledhja e të dhënave për shpenzimet në arsimin e lartë paraqet një sfidë më vete, pasi shpenzime të tilla ndodhin në nivele të ndryshme të qeverisjes, në sektorin privat, si dhe në ekonomi familjare. Kur bëhet fjalë për sektorin publik, të dhënat për shpenzimet mund të sigurohen nga Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave Publike (SIMFK), ndërsa në rastin e sektorit privat ato duhet të raportohen nga vetë institucionet e arsimit të lartë. Udhëzuesi UOE (2022) përcakton tri kategori të të dhënave për shpenzimet, ndërsa mundësia për mbledhjen e tyre në kontekstin kosovar është përshkruar në vazhdim.

FIN-STUDENTS: Numri i studentëve i përshtatur për financimin e arsimit (për vitin referent dhe për të dhënat financiare) sipas tipit të institucionit dhe kohës së studimit

Duke marrë parasysh se në Kosovë, të gjithë studentët në arsimin e lartë konsiderohen me kohë të plotë, nuk ka nevojë për ndonjë përshtatje të të dhënave të mbledhura për studentë. Këtu duhet pasur parasysh se viti akademik dhe viti fiskal nuk përputhen, prandaj është e arsyeshme që të dhënat për studentë nga viti akademik që fillon në shtator-tetor të vitit përkatës të shfrytëzohen me të dhënat për vitin fiskal vijues.

FIN1-SOURCE: Shpenzimet për arsim sipas burimit, llojit të transaksionit dhe nivelit arsimor

Institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë financohen nga granti qeveritar, por realizojnë edhe të hyra vetanake nga tarifatat e studentëve, veprimtaria komerciale, si dhe nga projektet kërkimore

dhe akademike. Nga buxheti qendror financohet edhe Agjencia për Akreditim e Kosovës dhe Qendra e Studentëve, të cilat i shërbejnë sistemit të arsimit të lartë. Shpenzimet tjera për arsimin e lartë përfshijnë bursat studentore të cilat jepen nga niveli qendror dhe ai lokal. Të gjitha shpenzimet e institucioneve publike regjistruhen në SIMFK dhe mund të zëbërthehen me lehtësi sipas kategorive shpenzuese – pagat, shpenzimet tjera rrjedhëse dhe shpenzimet kapitale siç kërkohej me Udhëzuesin UOE (2022).

Vështirësitë paraqiten në rastin e raportimit të shpenzimeve nga burimet private, siç janë shpenzimet e ekonomive familjare, e të cilat mund të sigurohen vetëm përmes anketave të rregullta të ekonomive familjare, të cilat në Kosovë nuk bëhen. Në kushte të tilla, raportimi korrekt i shpenzimeve publike për arsimin e lartë paraqet një hap domethënës drejt përmirësimit të standardeve ndërkombëtare për të dhëna statistikore.

FIN2-NATURE: Shpenzimet për arsim sipas tipit të institucionit, kategorisë shpenzuese dhe sipas nivelit arsimor

Në rastin e institucioneve publike këto të dhëna mund të merren nga sistemi SIMFK të klasifikuara në paga, shpenzime të tjera rrjedhëse (mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe subvencione e transfere) dhe shpenzime kapitale. Vështirësi të caktuar mund të paraqesë ndarja e pagave për personelin mësimor dhe jomësimor. Po ashtu, mund të jetë sfiduese mbledhja e të dhënave të kësaj natyre nga institucionet private, pasi ato i nënshtrohen kërkesave të raportimit financiar të përcaktuara me legjislacion tjetër.

6.2. Zhvillimi i sistemeve për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave

Të gjitha institucionet e akredituara të arsimit të lartë në Kosovë kanë sisteme elektronike për menaxhimin e studentëve, ku regjistrohen të dhënat për studentë, të cilat nevojiten për qëllime statistikore, siç janë: programi i studimit, gjinia, mosha, shtetësia, përkatësia etnike, etj. Në situatë ideale, këto sisteme do të ishin të sinkronizuara dhe do t'i transferonin të dhënat me automatizëm në periudha të caktuara në një sistem qendror, ku ato do të përpunoheshin dhe do të nxirreshin raporte të ndryshme statistikore sipas nevojës. Zhvillimi i një sistemi të mirëfilltë dhe gjithëpërfshirës për menaxhimin e informacionit në arsimin e lartë është pjesë e planeve afatmesme të MASHTI, pasi një sistem i tillë, jo vetëm që siguron të dhënat statistikore të nevojshme për vendimmarrje, por edhe mundëson një nivel më të lartë të mbikëqyrjes në institucionet e arsimit të lartë. Një strukturë e mundshme e një sistemi të tillë është përshkruar në studimin e fizibilitetit të hartuar nga Tabaku (2021).

Megjithatë, brenda një periudhe afatshkurtër mund të realizohet një SMIAL që nuk është medoemos i sinkronizuar, por mund t'i mbledhë dhe t'i përpunojë të dhënat për studentë nga institucionet e arsimit të lartë. Në vijim janë prezantuar të dhënat për studentët të cilat një sistem i tillë mund t'i mbledhë nga IAL-të në baza vjetore:

Programi i studimit

- Emërtimi dhe/ose kodi i alokuar nga AKA
- Niveli sipas ISCED (treshifror)
- Klasifikimi sipas ISCED-F-2013 (katërshifror)
- Gjuha e studimit

Numri personal

Emri

Mbiemri

Gjinia

Viti i lindjes

Vendi i lindjes (Komuna)

Shteti i lindjes

Vendbanimi (Komuna)

Shtetësia

Përkatësia etnike

Viti i studimit

Indikacioni nëse studenti regjistrohet për herë të parë në programin përkatës

Data e diplomimit (për të diplomuarit)

Të dhënat personale si numri personal, emri dhe mbiemri nuk kanë ndonjë funksion si të dhëna statistikore, por përdoren për qëllime verifikimi. Të dhënat e mësipërme mund të dorëzohen në tabela të formatit Excel dhe të ngarkohen në sistem. Në mungesë të një sistemi funksional dhe të dedikuar për arsimin e lartë, për përpunimin e të dhënave mund të shfrytëzohen edhe aplikacionet si Excel, SPSS, STATA, Access etj.

Me qëllim që të mbulohet gjithë spektri i arsimit të lartë, është e nevojshme mbledhja e të dhënave edhe nga institucionet që ofrojnë programe të nivelit ISCED 5. Këto institucione dallojnë nga institucionet tipike të arsimit të lartë dhe, në shumë raste, mund të jenë biznese apo organizata, të cilat kryejnë veprimtari të tjera shërbyese. Për këtë arsye, sistemet e tyre për menaxhimin e studentëve mund të jenë të ndryshme nga ato të institucioneve që ofrojnë programe të nivelit ISCED 6-8.

Kur bëhet fjalë për personelin akademik, të dhënat mund të mblidhen nga IAL-të në bazë vjetore dhe përmes formularëve të veçantë, pa kërkuar të dhëna personale. Formularë të tillë janë zhvilluar nga EUROSTAT dhe lehtësisht mund të përshtaten për nevojat e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë.

Të dhënat për shpenzimet duhet të përpunohen nga Ministria e Financave si autoritet qendror për mbikëqyrjen e shpenzimeve publike për arsimin e lartë, duke shfrytëzuar metodologjinë e përcaktuar me UOE (2022) dhe formularët përkatës të EUROSTAT, të cilët mund të përshtaten për kontekstin kosovar.

6.3. Paketa e treguesve kombëtarë të arsimit të lartë

Siç është shpjeguar në seksionin 4.3, Korniza e treguesve të arsimit (MASHT, 2017) përfshin 8 tregues për arsimin e lartë. Në vijim po i komentojmë këta tregues nga këndvështrimi i kërkesave për të dhëna që sigurojnë përlllogaritjen e tyre.

1 Shkalla bruto e regjistrimit

Numri i të regjistruarve në nivelin ISCED 5-8, pavarësisht moshës, në raport me popullsinë e grup-moshës që i korrespondon atij niveli të ISCED. Në këtë rast, mund të merret grupmosha 18-23 vjeç e cila pason moshën e zakonshme të përfundimit të shkollimit të mesëm të lartë ose, sipas modelit të EUROSTAT, grupmosha 20-24 vjeç. Të dhënat e nevojshme për këtë tregues janë në dispozicion që tani, përveç të dhënave për studentët e regjistruar në nivelin ISCED 5.

2 Shkalla neto e regjistrimit

Numri i të regjistruarve në nivelin ISCED 5-8, të grup-moshës që i korrespondon atij niveli të ISCED, në raport me popullsinë e asaj grup-moshe. Si në rastin e mësipërm, mund të merret grupmosha 18-23 vjeç ose 20-24 vjeç (sipas modelit të EUROSTAT). Për momentin, këto të dhëna nuk janë në dispozicion dhe nuk mund të llogaritet shkalla neto e regjistrimit.

3 Numri i studentëve në arsimin e lartë për 100,000 banorë

Ky tregues mat nivelin e përgjithshëm të pjesëmarrjes në arsimin e lartë, duke treguar proporcionin (apo dendësinë) e studentëve krahasuar me popullsinë në vend. Si i tillë, mund të llogaritet me të dhënat që aktualisht janë në dispozicion,

përveç të dhënave për studentët e regjistruar në nivelin ISCED 5

4 Përqindja e studentëve në arsimin e lartë sipas niveleve të ISCED 2011

Edhe këto të dhëna janë në dispozicion për nivelet ISCED 6-8, por mungojnë për nivelin ISCED 5.

5 Përqindja e studentëve në arsimin e lartë sipas fushave të studimit të ISCED-F-2013

ASK tanimë ka publikuar raportin e parë i cili sjell të dhëna për këtë tregues (ASK, 2022a), por raporti do të jetë i plotë me rastin e mbledhjes së të dhënave për studentët e nivelit ISCED 5. Po ashtu, nëse, në të ardhmen, të dhënat për fushat e studimit mbledhen sipas kodeve 4-shifrore të ISCED-F-2013, analiza e tillë mund të jetë edhe më e detajuar.

6 Indeksi i paritetit gjinor

Është herësi në mes të numrit të studentëve femra dhe meshkuj në arsimin e lartë. Me të dhënat ekzistuese mund të llogaritet për nivelet ISCED 6-8, në mënyrë kumulative dhe veç e veç për secilin nivel.

7 Përqindja e shpërndarjes së shpenzimeve publike rrjedhëse për arsimin e lartë;

Shpenzimet publike rrjedhëse për arsimin e lartë e shprehur si përqindje e totalit të shpenzimeve publike rrjedhëse në arsim. Parakusht për llogaritjen e këtij treguesi është konsolidimi i të dhënave për shpenzimet publike rrjedhëse për arsimin e lartë siç është përkrahur në seksionin 6.1.3, por edhe i shpenzimeve rrjedhëse për arsimin në përgjithësi, informatë që mund të nxirret nga llogaritë publike.

- 8 Shpenzimet e Qeverisë për një student si përqindje e BPV për kokë banori.

Ky tregues mat në mesatare shpenzimet e Qeverisë për një student të nivelit ISCED 5-8 në raport me të hyrat mesatare për kokë banori. Me këtë rast duhet pasur parasysh se Qeveria financon vetëm studentët e sektorit publik, ndërkohë që në numrin e studentëve duhet të përfshihen edhe ata të sektorit privat. Përveç kësaj, duhet të mblidhen të dhënat për studentët e nivelit ISCED 5, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Shpenzimet e qeverisë për një student është herësi i shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë për arsimin e lartë dhe numrit të përgjithshëm të studentëve të nivelit ISCED 5-8. Vlera e treguesit është raporti i këtij herësi me BPV për kokë banori.

Të gjithë treguesit e mësipërm janë relevantë dhe mund të raportohen në intervale kohore të rregullta. Përveç tyre, paketës së treguesve mund t'i shtohen edhe tregues të tjerë duke ndjekur shembullin e organizatave ndërkombëtare të prezantuar në tabelën 2. Disa nga këta tregues janë dhënë në vijim, ndërsa shpjegimet e plota për secilin prej tyre mund të gjinden në tabelën 2:

- Përqindja e studentëve të regjistruar në arsimin e lartë në institucione private,
- Shkalla e brendshme e mobilitetit,
- Shpërndarja e studentëve të regjistruar për herë të parë në arsimin e lartë sipas fushave të studimit,
- Përqindja e grave të regjistruara për herë të parë në arsimin e lartë sipas fushave të studimit,
- Shkalla bruto e diplomimit,
- Shkalla e përfundimit të shkollimit,
- Përqindja e personelit akademik të gjinisë femërore,
- Raporti student-personel akademik sipas tipit të institucionit (publik, privat),
- Përqindja e shpenzimeve rrjedhëse dhe kapitale në raport me shpenzimet totale në arsimin e lartë.

6.4. Kapacitetet dhe ndarja e përgjegjësive për statistikat e arsimit të lartë

Në Kosovë ende nuk është plotësisht e qartë se cili institucion i mbledh të dhënat për arsimin e lartë. Me gjithë rolin prijës të ASK-së, të dhëna nga institucionet e arsimit të lartë kërkon edhe MASHTI dhe AKA-ja. Kërkesat e dyzuara, jo vetëm që paraqesin ngarkesë të panevojshme për institucionet e arsimit të lartë, por mund të rezultojnë me gabime dhe mungesë konsistence në të dhëna. Prandaj, është me rëndësi që tri institucionet të gjejnë një formë të bashkëpunimit lidhur me të dhënat e arsimit të lartë.

Të dhënat për arsimin e lartë janë pjesë e publikimit të përbashkët të MASHTI dhe ASK, ku MASHTI e mbulon pjesën e arsimit parauniversitar, ndërsa ASK pjesën e arsimit të lartë. Kjo mund të vazhdojë kështu edhe një kohë, pasi në MASHTI ka mungesë të kapaciteteve për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave në arsimin e lartë, por, në afat të gjatë, duhet të krijohen kushtet që MASHTI t'i mbledhë dhe t'i përpunojë statistikat nga të gjitha nivelet e arsimit, në koordinim dhe nën mbikëqyrjen profesionale të ASK-së.

Sa i përket treguesve, duhet pasur parasysh se llogaritja e tyre, të shumtën e rasteve, kërkon shfrytëzimin e të dhënave demografike, financiare ose të të dhënave tjera që janë jashtë fushëveprimit të MASHTI. Prandaj, është e arsyeshme që vlerat e treguesve të llogariten nga ASK-ja, e cila ka staf profesional dhe burime të informacionit që kjo punë të kryhet me sukses.

Përveç publikimeve në formë të vjetarëve, të dhënat statistikore dhe treguesit duhet të publikohen edhe në bazën e të dhënave të ASK (ASK, 2023) që të jenë në dispozicion të të gjitha palëve të interesuara.

Mbledhja, kontrollimi, pastrimi, përpunimi dhe publikimi i të dhënave nuk mund të bëhen në mënyrë efektive nëse nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore brenda institucioneve të ngarkuara me këto detyra. Problemi i kapaciteteve të pamjaftueshme është i pranishëm në ASK dhe në MASHTI, prandaj duhet të adresohet me prioritet.

7. Përfundimet dhe rekomandimet

Pas hulumtimit të bërë del një përfundim i qartë, se statistikat e arsimit të lartë në Kosovë janë larg nga përmbushja e standardeve ndërkombëtare në këtë fushë dhe kanë nevojë për përmirësime të rëndësishme. Problemet janë të natyrës shumëdimensionale dhe përfshijnë:

- Mungesën e një përcaktimi të qartë të të dhënave statistikore dhe treguesve që duhet raportuar.
- Sistemet për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nuk janë të strukturuar në mënyrë që të garantojnë efektivitet në mbledhjen, ruajtjen, përpunimin dhe shkëmbimin e të dhënave mes institucioneve të ndryshme.
- Mungojnë kapacitetet teknike dhe organizative për të siguruar një proces të besueshëm të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave statistikore dhe treguesve.
- Shfrytëzimi i të dhënave statistikore dhe treguesve në procesin e vendimmarrjes është shumë i kufizuar për shkak të mungesës së të dhënave, por edhe kultura e vendimmarrjes pa u mbështetur në të dhëna rezultojnë me mungesë të kërkesës për të dhëna.

Analizat tregojnë se duhet të ndërmerren masa të menjëhershme që të rritet cilësia dhe shfrytëzimi i të dhënave statistikore në arsimin e lartë në Kosovë, duke investuar në infrastrukturë, teknologji dhe në trajnimin e stafit. Kërkohet një qasje më e koordinuar dhe më e përqendruar për mbikëqyrjen, raportimin dhe analizën e të dhënave. Në mungesë të këtyre masave, problemet në sektorin e statistikave të arsimit të lartë në Kosovë mund të intensifikohen dhe të dëmtojnë zhvillimin e ardhshëm të arsimit të lartë në vend.

Në kapitullin 5 janë analizuar sfidat kryesore të statistikave të arsimit të lartë në Kosovë, ndërsa në kapitullin 6 janë shqyrtuar mundësi për adresimin e tyre. Në vazhdim po i japim disa rekomandime të përgjithshme për veprim në funksion të përmirësimit të gjendjes së statistikave të arsimit të lartë:

- 1 MASHTI, AKA dhe agjencitë tjera qeveritare, në koordinim me ASK-në t'i përcaktojnë qartë kërkesat e tyre për të dhëna statistikore që do të jenë në funksion të informimit të publikut dhe vendimmarrjes së informuar. Udhëzimet metodologjike të UNESCO, OECD dhe EUROSTAT mund të jenë një pikënisje e mirë për këtë rrugëtim.
- 2 ASK ta marrë rolin udhëheqës në koordinimin e procesit të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave të arsimit të lartë, ndërsa MASHTI, AKA dhe agjencitë tjera qeveritare të sigurojnë qasje në të dhënat e tyre këtij sektori.
- 3 Sistemi SMIAL për mbledhjen e të dhënave nga institucionet e arsimit të lartë të mbindërtohet ose të zhvillohet i ri në mënyrë që të ofrojë të dhëna statistikore të nevojshme dhe të krahasueshme me standardet ndërkombëtare. Një proces i tillë mund të kërkojë investime domethënëse në teknologji të informacionit.

- 4 Deri në zhvillimin e një sistemi SMIAL që bën të mundur mbledhje të automatizuar të të dhënave nga institucionet e arsimit të lartë dhe përpunim efektiv të tyre, ASK dhe MASHTI të bëjnë zgjidhje të përkohshme, duke i mbledhur e përpunuar të dhënat përmes sistemeve që aktualisht janë në dispozicion.
- 5 MASHTI të fillojë punën në hartimin e paketës së treguesve për arsimin e lartë, duke përzgjedhur tregues të cilët mund të përlogariten me të dhënat që janë në dispozicion dhe i shërbejnë përcjelljes së progresit në fushën e arsimit të lartë.
- 6 MASHTI e ASK të analizojnë nevojat për ndryshime organizative e burime njerëzore që bëjnë të mundur prodhimin e statistikave cilësore në fushën e arsimit të lartë, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e secilit subjekt.

Literatura

AKA. (2023). *Programet e akredituara në vitin akademik 2022/23*. Gjetur në <https://akreditimi.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/10/Programet-e-Akredituara-2022-2023.pdf>

AKK. (2020). *Korniza Kombëtare e Kualifikimeve*. Prishtinë: Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. Gjetur në <https://akkks.rks-gov.net/Documents/DownloadDocument?fileName=Korniza%20Komb%20Kualifikimeve36064736.8453.pdf&original=Korniza%20kombetare%20kualifikimeve%202020.pdf>

AKK. (2023). *Lista e institucioneve dhe programeve të akredituara*. Gjetur në [https://akkks.rks-gov.net/Documents/DownloadDocument?fileName=Lista%20e%20Institucioneve%20t%20akredituar52023243.4255.xlsx&original=Lista%20e%20Institucioneve%20t%20akredituar%20\(2\).xlsx](https://akkks.rks-gov.net/Documents/DownloadDocument?fileName=Lista%20e%20Institucioneve%20t%20akredituar52023243.4255.xlsx&original=Lista%20e%20Institucioneve%20t%20akredituar%20(2).xlsx)

ASK. (2004). *Statistikat e Arsimit në Kosovë 2003-2004*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave e Kosovës. Gjetur në <https://ask.rks-gov.net/media/3795/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2003-2004.pdf>

ASK. (2015). *Statistikat e Arsimit 2014-2015*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave e Kosovës. Gjetur në <https://ask.rks-gov.net/media/1653/statistikat-e-arsimit-2014-2015.pdf>

ASK. (2017). *Programi i Statistikave Zyrtare 2018-2022*. Gjetur në <https://ask.rks-gov.net/media/3774/programi-strategjik-05012018.pdf>

ASK. (2022a). *Statistikat e arsimit të lartë sipas fushave të studimit për vitin akademik 2021/2022*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave e Kosovës. Gjetur në <https://ask.rks-gov.net/media/7153/arsimi-i-lart%20final-2021-2022.pdf>

ASK. (2022b). *Harta rrugore 2023*. Agjencia e Statistikave e Kosovës. Gjetur në <https://ask.rks-gov.net/media/7241/harta-rrugore-2023.pdf>

ASK. (2023). *ASK Database*. Gjetur në <https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/>

European Commission. (2022). *Kosovo 2022 Report - Accompanying the document "Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions"*. Gjetur në <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>

EUROSTAT. (2023a). *UOE QUESTIONNAIRES*. Gjetur në Education and Training Statistics: https://circabc.europa.eu/ui/group/d14c857a-601d-438a-b878-4b4cebd0e10f/library/56358708-5927-4055-a471-edafad45e134?p=1&n=10&sort=modified_DESC

EUROSTAT. (2023b). *Education and Training Database*. Gjetur në <https://ec.europa.eu/eurostat/web/education-and-training/data/database>

Hyseni, H., Shatri, B., Salihaj, J., & Pupovci, D. (2000). *Shifra dhe fakte për arsimin e Kosovës*. Prishtinë: KEC.

INSTAT. (2022a). *Statistika të regjistrimeve në arsim 2021-2022*. Tiranë: INSTAT. Gjetur në <http://www.instat.gov.al/media/9773/statistika-t%C3%AB-regjistrimeve-n%C3%AB-arsim-2021-2022.pdf>

INSTAT. (2022b). *Statistika të Diplomimeve 2020-2021*. Tiranë: INSTAT. Gjetur në http://www.instat.gov.al/media/9979/statistika-te-diplomimeve_2020-21.pdf

INSTAT. (2023). *Arsimi*. Gjetur në <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/>

Ligji Nr. 04/L-036. (2011). Ligji për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës. Gjetur në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2782>

Ligji Nr. 06/L-058. (2018). Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-036 për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës. Gjetur në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18421>

MAKSTAT. (2023). *Education and Science*. Gjetur në https://www.stat.gov.mk/OblastOps-to_en.aspx?id=5

Martin, M., & Sauvageot, C. (2011). *Constructing an indicator system or scorecard for higher education - A practical guide*. Paris: UNESCO. Gjetur në <http://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/constructing-an-indicator-system-or-scorecard-for-higher-education-a-practical-guide-2011-en.pdf>

MAS. (2022). *Vjetari statistikor për arsimin dhe sportin 2020-2021 dhe seri kohore*. Tiranë: Ministria e Arsimit dhe Sportit. Gjetur në <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/10/VJETARI-STATISTIKOR-P%C3%8BR-ARSIMIN-DHE-SPORTIN-2020-2021-ALB-FINAL.pdf>

MASHT. (2010). *Korniza e treguesve të arsimit*. Prishtinë: MASHT. Gjetur në https://childhub.org/sites/default/files/library/attachments/korniza_e_treguesve_te_arsimit.pdf

MASHT. (2012). *Treguesit e arsimit në Kosovë 2009/10, 2010/11 DHE/ 2011/12*. Prishtinë: MASHT. Gjetur në <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/treguesit-e-arsimit-ne-kosove.pdf>

MASHT. (2014). *Raport statistikor me tregues arsimorë 2012/13 dhe 2013/14*. Prishtinë: MASHT. Gjetur në <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/raport-statistikor-me-tregues-arsimore-2012-13-dhe-2013-14.pdf>

MASHT. (2017). *Korniza e treguesve të arsimit në Kosovë*. Prishtinë: MASHT. Gjetur në <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/korniza-e-treguesve.pdf>

MASHT-ASK. (2016). *Statistikat e arsimit në Kosovë 2015/16*. Prishtinë: MASHT-ASK. Gjetur në <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-shq.pdf>

MASHTI. (2022a). *Strategjia e Arsimit 2022-2026*. Prishtinë: MASHTI. Gjetur në <https://masht.rks-gov.net/strategjia-e-arsimit2022-2026/>

MASHTI. (2022b). *Strategjia e Arsimit 2022-2026 - Plani i Veprimit*. Prishtinë: MASHTI. Gjetur në <https://masht.rks-gov.net/strategjia-e-arsimit-2022-2026plani-i-veprimit/>

MASHTI. (2022c). *Raport vjetor statistikor me tregues arsimorë 2021-2022*. Prishtinë: MASHTI. Gjetur në <https://masht.rks-gov.net/raport-vjetor-statistikorme-tregues-arsimore/>

MASHTI-ASK. (2022). *Statistikat e arsimit në Kosovë 2021/22*. Prishtinë: MASHTI-ASK. Gjetur në <https://masht.rks-gov.net/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2021-2022/>

MONSTAT. (2023). *Higher Education*. Gjetur në <https://www.monstat.org/eng/page.php?id=190&pageid=75>

OECD. (2017). *OECD Handbook for Internationally Comparative Education Statistics*. Paris: OECD. Gjetur në <https://www.oecd.org/publications/oecd-handbook-for-internationally-comparative-education-statistics-9789264279889-en.htm>

OECD. (2022). *Education at a Glance 2022 - OECD Indicators*. Paris: OECD. Gjetur në <https://www.oecd.org/education/education-at-a-glance/>

OECD. (2023). *Online Education Database*. Gjetur në <https://www.oecd.org/education/database.htm>

Geveria e RKS. (2022). *Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së StabilizimAsociimit (PKZMSA) 2022-2026*. Gjetur në https://www.mei-ks.net/repository/docs/1%20PKZMSA%202022-2026_shq.pdf

RZS. (2022). *Visoko Obrazovanje 2021/22*. Beograd: RZS. Gjetur në <https://publikacije.stat.gov.rs/G2022/Pdf/G20226012.pdf>

RZS. (2023). *Higher Education*. Gjetur në <https://www.stat.gov.rs/en-us/oblasti/obrazovanje/visoko-obrazovanje/>

Tabaku, Z. (2021). *Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë - Studim i fizibilitetit*. Prishtinë: KEC-QAINT. Gjetur në <http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2022/01/QAINT-Studimi-i-Fizibilitetit-ALB.pdf>

UIS. (2023). *UIS Statistics*. Gjetur në <http://data.uis.unesco.org/#>

UNESCO. (2009). *Education Indicators - Technical Guidelines*. UNESCO. Gjetur në https://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/education-indicators-technical-guidelines-en_0.pdf

UNESCO. (2012). *International Standard Classification of Education ISCED 2011*. Montreal: UIS. Gjetur në <https://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/international-standard-classification-of-education-isced-2011-en.pdf>

UNESCO. (2015). International Standard Classification of Education - Fields of education and training 2013 (ISCED-F 2013) -Detailed field descriptions. Montreal: UIS. Gjetur në <https://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/international-standard-classification-of-education-fields-of-education-and-training-2013-detailed-field-descriptions-2015-en.pdf>

Universiteti i Prishtinës. (2023). *Numri i studentëve sipas gjinisë të regjistruar në vitin aktual*. Gjetur në <https://app.powerbi.com/view?r=eyJrljoiMWJlOGU1MzgtMTBiNC00ZW1LThkYWEtZmU1ZTRjYjNINzBlliwidCI6ImMwMzRjM2I0LWQwMmItNDM2MS04M2YwLTNiMWI5ZWE0MzcwYyIsImMiOjh9&pageName=ReportSection>

UOE. (2022). UOE data collection on formal education - Manual on concepts, definitions and classifications. MONTREAL, PARIS, LUXEMBOURG: UNESCO-OECD-EUROSTAT. Gjetur në <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/1014465/13741415/UOE+2022+Manual.pdf/dbe08eb1-9a5c-b682-5103-ad841b2cfa09?t=1658845034385>

World Bank. (2023). *Education Data*. Gjetur në <https://data.worldbank.org/topic/4>

Shtojcë: Lista e të intervistuarve

Emri dhe mbiemri	Pozita	Institucioni
Naim Gashi	Drejtor	Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA)
Ilirjanë Ademaj	Zyrtare e Lartë për vlerësim dhe monitorim	Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA)
Naime Rexhepi	Udhëheqëse e Divizionit të Statistikave Sociale	Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
Advie Uka	Zyrtare e statistikave të arsimit	Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
Xhavit Rexhaj	Ekspert i Arsimit	Kolegji AAB, Prishtinë
Shqipe Bruçi	Zv. udhëheqëse e Divizionit për Integrim Evropian	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)
Enver Mekolli	Zyrtar për Statistika	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)
Qazim Tahiri	Zyrtar përgjegjës në Zyrën për Teknologji të Informacionit	Universiteti i Prishtinës
Edona Maloku-Bërdyna	Zëvendësministre	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)
Burim Gashi	Zv. drejtor i departamentit për arsim të lartë	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)

